



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 266 Akti

Nr. 296 Vendimi
Tiranë, më 16.9.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në Tiranë, në datën 14 shtator 2020, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Alket Mersini**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) në datën 15.1.2019 zhvilloi procedurën e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se z. Alket Mersini, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.1.2019, u caktua me mirëkuptim si kryesues komisionerja Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini.
5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për z. Alket Mersini, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini. Në përfundim të veprimeve verifikuese për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Alket Mersini.

12. Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 20.7.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në datën 20.7.2020 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

¹ Raporti nr. *** prot., datë 11.10.2018.

² Raporti nr. *** prot, datë 2.11.2017.

³ Raporti nr. *** prot., datë 15.5.2020.

Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 21.07.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 31.8.2020.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 8.9.2020.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 14.9.2020, ora 9:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Alket Mersini ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut dhe; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini.

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

23.2 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Pasuria e llojit “apartament banimi”⁵, me sipërfaqe 110 m², me vlerë **58,406 euro**, i ndodhur në rezidencën “****”, Rruga ***, Tiranë, pasuri e paregjistruar në regjistrat publikë dhe se zotëron 50% pjesë të saj. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e dy apartamenteve 1+1, adoptuar në një apartament, të ndodhur në Elbasan, sipas aktmarrëveshjes datë 25.3.2011, në vlerën prej 12,500,000 lekë.

▪ **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

Referuar DPV/2010 konstatohet se subjekti ka deklaruar si adresë banimi rezidencën “****”, Tiranë, ndërsa në deklarinimin e bërë veçmas, personi i lidhur ka deklaruar se ka tërhequr në “Alpha Bank” shumën prej 2,100,000 lekë, për prenotimin e një shtëpie në vendin e quajtur “****”, Tiranë.

Referuar DPV/2011 konstatohet se subjekti ka deklaruar: (i) aktmarrëveshjen e datës 25.3.2011, për shitjen e shtëpisë në Elbasan dhe; (ii) kontratë porosie të datës 21.10.2011, për apartamentin e ndodhur në rezidencën “****”, Tiranë, me sipërfaqe 110.2 m², me çmim total 58,406 euro, shumë për të cilën ka deklaruar se është likuiduar plotësisht, *por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.*

▪ **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

ASHK⁶, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij figuron e regjistruar pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***, z.k. ***, e llojit “apartament”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konstatohet se nëpërmjet kontratës⁷ së datës 21.10.2011 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin me sipërfaqe 110.2 m² në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në adresën: Komuna ***, rezidenca “****”, Rruga ***, Tiranë. Në nenin 3 të kësaj kontratë përcaktohet se vlera totale e shitjes së këtij apartamenti është 58,406 euro dhe plani i përcaktuar i pagesave parashikon se kësti i parë 58,406 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës.

Gjithashtu, rezulton se në datën 25.10.2017 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar kontratën⁸ e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me shoqërinë “****” sh.p.k. Referuar kësaj kontrate, në favor të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij kalon në pronësi pasuria e sipërcituar dhe se palët kanë deklaruar se çmimi i blerjes është likuiduar mes tyre në ekzekutim të të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së datës 21.10.2011.

❖ **Analiza e burimeve të deklaruara dhe pagesave të kryera për krijimin e kësaj pasurie**

Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të bëra ndër vite në ILDKPKI u konstatua se, në deklarinimin e bërë veçmas në DPV/2010 personi i lidhur në rubrikën “*Deklarimi i interesave private – pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme*” ka deklaruar se ka tërhequr në “Alpha Bank” shumën prej 2,100,000 lekë, për prenotimin e një shtëpie në vendin e quajtur “****”,

⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks **** në dosjen e ILDKPKI): (1) kontratë për ndërtim apartamenti nr. ****, datë 21.10.2011; (2) aktmarrëveshje e datës 25.3.2011; (3) aktmarrëveshje e datës 5.12.2003; (4) deklaratë nr. ****, datë 22.12.2003.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 9.10.2019.

⁷ Kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2011.

⁸ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2017.

Tiranë, ndërsa në DPV/2011, në rubrikën “*Ndryshimet e interesave private – pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme*” subjekti ka deklaruar kontratë porosie të datës 21.10.2011, për apartamentin e ndodhur në rezidencën “****, Tiranë”, me sipërfaqe 110.2 m², me çmim total 58,406 euro, shumë për të cilën ka deklaruar se është likuiduar plotësisht.

I pyetur nga Komisioni për shumën e deklaruar si të tërhequr në vitin 2010 në “Alpha Bank” dhe destinacionin e saj subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se⁹ *shuma prej 2,152,000 lekë, në datën 28.4.2010 është kaluar nga llogaria e bashkëshortes në llogarinë e vëllait të saj, z. B.Z., i cili ishte i punësuar pranë “Alpha Bank” (me përshkrim “dhënie borxh”, se banka kërkonte një arsye), me qëllim për blerje euro, me kurs këmbimi më të favorshëm se ai i bankës dhe pasi ai ka kryer konvertimin në shumën afërsisht 15,000 euro, jua ka kthyer cash brenda muajit pasardhës. Kjo shumë është përdorur si parapagim cash për likuidimin e kësteve të apartamentit të *** në Tiranë në vitin 2010, sipas kontratës së kaparit, -pra, për parapagimin e kështit të parë për blerjen e këtij apartamenti.*

“Alpha Bank”¹⁰, konfirmon se në datë 28.4.2010 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është transferuar në llogarinë e z. B.Z., shuma prej 2,152,000 lekë me përshkrim “*kalim nga M.M., për B.Z., dhënie borxh*”.

I pyetur nëse ka lidhur kontratë sipërmarrje/porosie për këtë pasuri gjatë vitit 2010 apo më parë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se¹¹ *për prenotimin e apartamentit të mësipërm, ka lidhur kontratë kapari më 3.5.2010 midis tij dhe bashkëshortes (njëra palë) dhe shoqërisë “****” sh.p.k., (pala tjetër).*

Ndërsa i pyetur për periudhën, mënyrën e pagesave të kryera në favor të shoqërisë ndërtuese si edhe se kur e ka marrë në dorëzim këtë apartament, subjekti i rivlerësimit deklaroi se¹² *shoqërisë “****” sh.p.k., i janë paguar cash, (i) në maj 2010 vlera prej 15,000 euro; (ii) në prill 2011 vlera prej 3,200,000 lekë (sa tërhequr në “Alpha Bank” datë 1.4.2011) dhe; (iii) në maj 2011 vlera prej 3,100,000 lekë (sa tërhequr në “Alpha Bank” datë 2.5.2011). Gjithsej 15,000 euro + 45,000 euro (6,300,000 lekë/140 lek/euro) = 60,000 euro. Apartamenti është marrë në dorëzim dhe ka hyrë për të banuar në dhjetor 2010.*

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka depozituar dokumentacionin provues si vijon: (i) vërtetim nr. ***, datë 13.2.2020 lëshuar nga “Alpha Bank”, sipas të cilit vërtetohet se z. B.Z., është punonjës i kësaj banke; (ii) tre mandate bankare të këmbimit të vlerave monetare nga z. B.Z., në datat 12, 13 dhe 14 maj 2010; (iii) kontratë kapari e datës 3.5.2010 lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe; (iv) vërtetim nr. *** prot., nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila vërteton kohën e pagesës së kësteve për shtëpinë.

Nga verifikimi i mandateve bankare të “Alpha Bank”, të depozitura nga subjekti, konfirmohet se z. B.Z., (i) në datën 12.5.2010 ka konvertuar shumën prej 1,493,800 lekë në valutën euro, përkatësisht në vlerën 11,000 euro; (ii) në datë 13.5.2010 ka konvertuar shumën prej 366,390 lekë në valutën euro, përkatësisht në vlerën 2,700 euro dhe; (iii) në datën 14.5.2010 ka konvertuar shumën prej 271,800 lekë në valutën euro, përkatësisht në vlerën 2,000 euro.

⁹ Pyetëtori nr.2, pyetja nr. 9, nënpyetjet i dhe ii/ përgjigjet e dërguara nga subjekti.

¹⁰ Shkresat me nr. *** prot., datë 16.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.2.2020.

¹¹ Pyetëtori nr.2, pyetja nr. 10, nënpyetjet i dhe ii/ përgjigjet e dërguara nga subjekti.

¹² Pyetëtori nr.2, pyetja nr. 12, nënpyetjet i dhe ii/ përgjigjet e dërguara nga subjekti.

Referuar kontratës së kaparit të datës 3.5.2010 (shkresë e thjeshtë) të lidhur mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “***” sh.p.k., përfaqësuar nga z. G.S., konstatohet se objekti i saj është pagimi nga kapardhënesi i çmimit 58,406 euro për rezervimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe 110.2 m².

Në nenin 2 të kësaj kontrate me titull “afati dhe likuidimi i kaparit” përcaktohet se afati i kontratës do të jetë deri në 31.12.2011 dhe se në këtë datë përfundon efekti ligjor i saj, ndërsa lidhur me planin e pagesave në këtë kontratë parashikohet se, kapardhënesi do të likuidojë gjithë vlerën e shitjes si garanci kapari në mënyrë periodike si vijon: (i) kësti i parë në vlerën 15,000 euro brenda muajit maj 2010; (ii) kësti i dytë në vlerën 15,000 euro brenda muajit janar 2011; (iii) kësti i tretë në vlerën 15,000 euro brenda muajit qershor 2011 dhe; (iv) kësti i fundit në vlerën 13,406 euro, jo më vonë se dhjetor 2011.

Ndërsa, referuar vërtetimit të datës 11.2.2020, shoqëria “***” sh.p.k., ka konfirmuar se likuidimi për blerjen e pasurisë së sipërcituar është kryer në mënyrë periodike, me pagesa të ekzekutuara *cash* pranë shoqërisë si vijon: (i) në datën 18.5.2010 është paguar shuma prej 15,000 euro; (ii) në datën 5.4.2011 është paguar shuma prej 3,200,000 lekë dhe; (iii) në datën 4.5.2011 është paguar shuma prej 3,100,000 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Alpha Bank” rezulton se: (i) në datën 1.4.2011 ka tërhequr *cash* në total shumën prej 3,200,000 lekë dhe; (ii) në datën 2.5.2011 ka tërhequr *cash* në total shumën prej 3,100,000 lekë.

↓ Sa më sipër, Komisioni konstatoi se:

- (i) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën “Vetting”, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.
- (ii) pagesat për blerjen e kësaj pasurie janë bërë gjatë vitit 2010 dhe 2011, por ato nuk përputhen me parashikimet e bëra në kontratën e sipërmarrjes.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera shpjegoi se në deklaratën “Vetting” është harruar që krahas burimit të cituar në këtë deklaratë, të vendosej si burim krijimi kursimet ndër vite, nëpërmjet të cilave është krijuar gjendja e llogarisë në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortes. Siç ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ dhe siç vërtetohet plotësisht nga dokumentacioni i dorëzuar, konkretisht nga dokumentacioni bankar, shkresat dhe konfirmimet e dërguara nga shoqëria “***” sh.p.k., rezulton se: likuidimi për blerjen e pasurisë së sipërcituar është kryer në mënyrë periodike, me pagesa të ekzekutuara *cash* pranë shoqërisë si vijon: (i) në datën 18.5.2010 është paguar shuma prej 15,000 euro; (ii) në datë 5.4.2011 është paguar shuma prej 3,200,000 lekësh dhe; (iii) në datën 4.5.2011 është paguar shuma prej 3,100,000 lekësh. Në vijim ka sqaruar se, kontrata noteriale e sipërmarrjes e datës 21.10.2011 është paraprirë nga një kontratë kapari dhe meqënëse në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes ishte likuiduar tërësisht vlera e apartamentit të porositur, në këtë kontratë është parashikuar shkurtimisht se kësti i parë 58,406 euro është paguar me nënshkrimin e kontratës. Në fakt, ky parashikim në kontratë më shumë duhet të ketë ngelur nga kontrata të ngjashme, sepse vlera e plotë e apartamentit është 58,406 euro, e cila në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes është likuiduar tërësisht.

❖ Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Siç u evidentua më sipër, në DPV/2010 personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit)¹³ ka deklaruar tërheqjen e shumës prej 2,100,000 lekë në “Alpha Bank”, për prenotimin e një shtëpie në vendin e quajtur “****”, Tiranë. Gjithashtu, ka rezultuar se në datën 28.4.2010 nga llogaria e personit të lidhur është transferuar në llogarinë e vëllait të saj, z. B.Z., shuma prej 2,152,000 lekësh.

Komisioni vëren se, megjithëse personi i lidhur në DPV/2010 ka deklaruar tërheqjen e shumës prej 2,100,000 lekësh nga llogaria e saj në “Alpha Bank”, por ndërkohë nga ana tjetër rezulton se kjo shumë është transferuar në llogarinë e vëllait të saj, duke bindëse shpjegimet e subjektit për arsyet e transferimit të kësaj shume, me qëllim konvertimin e saj në monedhën euro, duke konsideruar faktin e konfirmuar se vëllai i bashkëshortes ka qenë punonjës i kësaj banke, dhe se, sipas politikave të bankave, punonjësit kanë kurs preferencial të këmbimit valutor.

Për më tepër, pas analizës së provave të depozituara nga subjekti, dokumenteve shkresore të llojit “mandat bankar”, konfirmohet se vëllai i bashkëshortes së subjektit në datat 12, 13 dhe 14.5.2010, nëpërmjet tri transaksioneve/veprimeve bankare, prej shumës së transferuar nga personi i lidhur në llogarinë e tij (vlera prej 2,152,000 lekë), ka konvertuar shumën prej 2,131,190 lekë në monedhën euro, në total për vlerën prej 15,700 euro – vlera monetare të tërhequra *cash* prej tij mbas konvertimit.

Gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re kontratën e kaparit të datës 3.5.2010, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila ka si objekt të saj pagimin nga kapardhënësi i kaparit për rezervimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe 110.2 m² (apartamentit objekt vlerësimi), kundrejt çmimit 58,406 euro. Shoqëria “****” sh.p.k., ka konfirmuar se¹⁴ referuar kontratës së kaparit, në datën 18.5.2010 është paguar nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur shuma prej 15,000 euro.

Gjithashtu, Komisioni vëren se në DPV/2010, subjekti i rivlerësimit, krahas shënimit të adresës ku është i regjistruar në gjendjen civile, ka deklaruar si vendqëndrim tjetër/adresë ku banon rezidencën “****”, Tiranë.

Në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar si prova të rëndësishme deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur në DPV/2010 në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni krijoi bindjen se pasuria objekt vlerësimi është prenotuar që në vitin 2010 dhe se shuma e transferuar nga llogaria e bashkëshortes së subjektit me burim kursimet ndër vite, më pas e konvertuar në euro nga vëllai i saj dhe e tërhequr *cash* prej tij, ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë apo dhënies së kaparit në favor të shoqërisë ndërtuese. Mosdeklarimi i kësaj shume në deklaratën “Vetting” si burim krijimi i kësaj pasurie duket të ketë ardhur si pasojë e harresës apo pakujdesisë së treguar, për sa kohë në DPV/2010 është deklaruar destinacioni dhe qëllimi i përdorimit të saj.

Analiza ligjore/financiare e krijimit të llogarisë bankare në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortes së subjektit, e cila ka shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë

Referuar DPV/2009, konstatohet se në deklarinimin e bërë veçmas personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar **llogarinë bankare depozitë në “Alpha Bank”, në shumën prej**

¹³ Deklarimi i bërë veçmas.

¹⁴ Referuar vërtetimit të datës 11.2.2020.

2,100,000 lekë me burim krijimi: (i) **kursimet ndër vite** dhe; (ii) **kursimet nga pagat gjatë vitit 2009**.

“Alpha Bank”¹⁵, konfirmon se në datën 7.9.2009 personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka depozituar *cash* shumën prej 2,100,000 lekë, duke e kaluar të gjithë shumën në depozitë me afat.

Komisioni verifikoi deklaratat periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në ILDKPKI, për të evidentuar deklaratimet e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* ndër vite për periudhën 2003 – 2008, si dhe mundësinë e krijimit të tyre, me qëllim analizimin e burimit të krijimit të kësaj depozite.

Në deklarinimin fillestar të pasurisë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar në total gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën prej 2,900,000 lekë. Referuar DPV/2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të gjendjeve *cash* në vlerën 2,900,000 lekë. Në vijim, konstatohet se në DPV/2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa kursimesh në formë likuiditesh *cash*.

Referuar **DPV/2006** konstatohet se, në rubrikën “*Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme*”¹⁶, subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën prej **500,000 lekësh**, me burim krijimi të ardhurat nga pagat për vitin 2006. Referuar **DPV/2007** konstatohet se, në rubrikën “*Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*”, subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën prej **600,000 lekësh**, me burim krijimi të ardhurat nga pagat për vitin 2007, ndërsa, referuar **DPV/2008** konstatohet se, në rubrikën “*Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*”, subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën prej **600,000 lekësh**, me burim krijimi të ardhurat nga pagat për vitin 2008.

Pra, nga verifikimi i deklaratimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI rezulton se, në fund të vitit 2008 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja e tij) kanë pasur të akumuluar gjendjen e kursyer në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 1,700,000 lekësh.

Referuar analizës financiare¹⁷ të kryer nga Komisioni konstatohet se vitet 2006, 2007 dhe 2008 paraqiten me balancë pozitive të fondeve. Si rrjedhim, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftushme për të justifikuar plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* e përkatësisht: (i) për vitin 2006 shumën prej 500,000 lekësh, (ii) për vitin 2007 shumën prej 600,000 lekësh dhe; (iii) për vitin 2008 shumën prej 600,0000 lekësh.

➤ Sa më sipër, bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2009 - 7.9.2009, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për krijimin e depozitës në shumën 2,100,000 lekë (pasuri kjo e krijuar duke përdorur edhe kursimet e mbartura në vlerë 1,700,000 lekë, referuar deklaratimeve të subjektit).

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 16.9.2019.

¹⁶ Rubrikë ku pasqyrohen shtesat/pakësimet e pasurisë.

¹⁷ Analiza e treguesëve financiarë i bashkëlidhet si aneks këtij materiali.

- Pasqyra e likuiditeteve për fillimin, mbylljen e periudhës, si dhe ndryshimi i tyre paraqitet më poshtë:

Pasqyra e likuiditeteve dhe ndryshimi i tyre për subjektin Alket Mersini (periudha 1.1.2009 - 7.9.2009)			
	Vendndodhja	Gj. 1.1.2009 Në lekë	Gj. 7.9.2009 Në lekë
	<i>Cash në banesë</i>	1,700,000	0
Subjekti i rivlerësimit			
	Banka “Raiffeisen”	-74,432	- 73,320
Bashkëshortja			
	“Alpha Bank”	0	2,100,000
	Banka “BKT”	101,270	276
	Banka e Shqipërisë	800,000	0
	“Credins Bank”	14,020	20
	Totale	2,526,838	2,026,976
	Ndryshim mjete monetare (zvogëlim)		499,862

- Ndërsa pasqyra përmbledhëse – analiza e treguesve financiarë, paraqitet si më poshtë:

Analiza financiare periudha 1.1.2009 - 7.9.2009	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin për periudhën	673,651
Të ardhura neto nga paga, shpërblime dhe honorare bashkëshortja për periudhën	652,506
Të ardhura të tjera, interesa kreditore	27,876
Total të ardhura/të hyra financiare	1,354,033
Pagesë këste kredie “Raiffeisen Bank” (Disb 2008)	114,644
Shpenzime interesa <i>overdrafti</i> dhe komisione	8,391
Shpenzime për qira deklaruar	40,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	364,320
Total shpenzime/pagesa	527,355
Ndryshim mj.monetare deklaruar <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe	1,700,000
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	- 1,200,138
Mjete monetare të disponueshme	1,326,540

↓ Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin në datën 7.9.2009 të depozitës në shumën prej 2,100,000 lekë në emër të personit të lidhur në “Alpha Bank”.

↓ Si rrjedhim, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit të ndodhur në rezidencën “****”, Tiranë.

📌 **Analiza e të ardhurave të përfitura nga shitja e apartamentit në Elbasan, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi**

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se, në bazë të aktmarrëveshjes¹⁸ së datës 25.3.2011 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i kanë shitur shtetasve H., dhe N.A., ambientin e porositur¹⁹ (*dy apartamente banimi me strukturë 1+1*) me

¹⁸ Konfirmuar me dokumentin noterial, vërtetim nënshkrimi nr. **** rep., datë 25.3.2011, hartuar nga notere A.B.

¹⁹ Sipas aktmarrëveshjes së datës 5.12.2003 nënshkruar me shoqërinë **** sh.p.k.

sipërfaqe totale 120 m²) tek shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2003 për shumën prej 12,500,000 lekësh. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar se në datën e nënshkrimit është likuiduar shuma prej 12,300,000 lekësh në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në “Alpha Bank”, ndërsa kësti i dytë prej 200,000 lekësh do të likuidohej brenda muajit korrik 2011.

Nga analizimi i kësaj aktmarrëveshjeje konstatohet se, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i kanë kaluar shtetasve të sipërpërmendur të drejtat që gëzonin mbi pasurinë e prenotuar nga ana e tyre në vitin 2003, të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në Elbasan.

Referuar të dhënave nga “Alpha Bank” konfirmohet se, në datë 25.3.2011 është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit shuma 12,300,000 lekë me përshkrimin “*kalim nga N.A., për blerje apartamenti*”. Ndërsa, në lidhje me kohën e pagesës nga blerësi të shumës prej 200,000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se²⁰, *kjo shumë është paguar cash, brenda vitit 2011.*

📌 Kronologjia e blerjes/shitjes së apartamentit me sipërfaqe prej 120 m², në Elbasan

Referuar aktmarrëveshjes së datës 5.12.2003, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur tek shoqëria “****” sh.p.k., ndërtimin e dy apartamenteve me strukturë 1+1, të cilat do të adoptoheshin me shpenzimet e firmës me sipërfaqe totale 120 m², për çmimin 4,000,000 lekë. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje, në datën e nënshkrimit është likuiduar shuma 3,000,000 lekë, ndërsa në bazë të deklaratës së datës 22.12.2003, subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij dhe përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., deklarojnë pagesën e këstit të fundit në vlerën 1,000,000 lekë.

Në deklaratën fillestare të pasurisë²¹ të depozituar në ILDKPKI konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë pasuri, si dhe shumën prej 4,000,000 lekë, të paguar deri në datën 31.12.2003.

I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se²², *deklarata e datës 19.3.2004 është plotësuar për herë të parë sapo kishte hyrë në fuqi dhe filluar të zbatohet ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Akoma nuk ishte e qartë se çfarë dhe si duhej të plotësohej kjo deklaratë...Meqenëse nuk ishte bërë juridikisht pronar i këtij apartamenti apo i kësaj pasurie të paluajtëshme, ka menduar se nuk duhej ta deklaronte. Pasi është qartësuar në lidhje me parashikimet ligjore, ka kryer deklarimin në vitin pasardhës.*

Për më tepër, subjekti i rivlerësimit referon legjislacionin në fuqi për kohën lidhur me deklarimin e pasurive, sipas të cilit në nenin 25 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 (referuar si më sipër) përcaktohej se, “...përpara deklarimit, deklaruesit duhet t’i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës...”. Ndërsa në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se, “...kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë ose ai i ulët thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim...”

²⁰ Pyetëtori nr.2, pyetja nr. 11, nënpyetja ii/ përgjigjia e dërguar nga subjekti.

²¹ Dorëzuar nga subjekti në datë 19.3.2004 në ILDKPKI.

²² Pyetëtori nr.2, pyetja nr. 2, nënpyetja ii/ përgjigjia e dërguar nga subjekti.

Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2004 të dorëzuar në ILDKPKI konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 120 m², në ndërtim e sipër, me vlerë 3,300,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) 10,000 dollarë të dhëna nga vëllai prej heqjes dorë nga bashkëpronësia në shtëpinë e prindërve dhe; (ii) 10,000 dollarë të ardhura nga familja e bashkëshortes.

Sa më sipër, konstatohet mospërputhje mes çmimit të blerjes së kësaj pasurie të deklaruar në DPV/2004 dhe atij të parashikuar në aktmarrëveshjen e datës 5.12.2003.

I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë mospërputhje në deklaram, subjekti i rivlerësimit deklaroi se²³, *mospërputhja është një gabim material, pasi në deklaram është shënuar 3,300,000 lekë kur në realitet duhej të shënohej 33,000 USD dhe se, likuidimi i vlerës është kryer në dollarë.*

Ndërsa, i pyetur për burimin e krijimit të kësaj pasurie, krahas deklaramit të tij të bërë në DPV/2004, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, *burimi i të ardhurave për pagesën e shumës 4,000,000 lekë, janë, (i) kursimet nga të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes; (ii) të ardhura nga shitja e shtëpisë në vitin 2000, në vlerën 1,900,000 lekë; (iii) dhurimi i shumës 10,000 USD (≈ 1,210,000 lekë) nga familja e bashkëshortes; (iv) pagesë e dhënë prej 10,000 USD (≈ 1,210,000 lekë) nga vëllai në këmbim të pjesës së tij takuese në apartamentin e privatizuar në vitin 1993 nga prindërit, banesë në të cilin deklaron se ka jetuar edhe ai vetë deri në vitin 2001 dhe; (v) të ardhura nga projekti “****” me Universitetin “****”, Elbasan, në prill 2003 – shkurt 2004 në shumën 490 euro x 140 lek/euro ≈ 68,000 lekë.*

Lidhur me kronologjinë e kryrjes së pagesave në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për porositjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se²⁴, *në vitin 2003 kursimet e tij dhe të bashkëshortes ishin në “Alpha Bank” në llogari, në monedhën lekë. Në këtë llogari, gjithashtu, depozituan në datën 29.7.2003 shumën prej 1,100,000 lekësh, e cila i takon një pjese nga shuma prej 10,000 USD të dhuruara po në këtë vit nga nëna e bashkëshortes ekuivalente me 1,210,000 lekë. Totali i shumës së depozituar në llogari bankare, në vlerën prej 4,873,973 lekësh, është konvertuar në datën 8.9.2003 me kursin 121.5 ALL/USD në 40,000 USD, duke i kaluar në llogari bankare të z. A.B., (kambist) vlerën në lekë. Po këtë ditë, kanë marrë cash kundërvlerën e 40,000 USD prej z. A.B., (kambist) dhe këtë vlerë, së bashku me vlerën 10,000 USD të dhënë nga vëllai i tij, z. E.M., në këmbim të heqjes dorë nga pjesa takuese nga shtëpia e privatizuar në vitin 1993, e kanë depozituar në një depozitë bankare të përbashkët me bashkëshorten, po në datën 8.9.2003, në “Alpha Bank” (total 50.115 USD).*

Në vijim ka shpjeguar se, *në datën 5.12.2003, ditën e lidhjes së aktmarrëveshjes kanë prishur depozitën para afatit dhe kanë kryer tërheqjen e shumës 24,690 USD (ekuivalente me 3,000,000 lekë sipas kursit të blerjes), të cilën ia kanë dorëzuar në dollarë ndërtuesit të apartamentit. Pjesa tjetër prej 8,230 USD (ekuivalente me 1,000,000 lekë sipas kursit të blerjes) është tërhequr në datën 22.12.2003, me qëllimin likuidimin total të çmimit të përcaktuar në aktmarrëveshje (24,690 USD + 8,230 USD = 33,000USD x 121.5 lekë/USD). Gjithashtu, është tërhequr shuma prej 17,536 USD, pjesa e mbetur nga vlera 50,000 USD e depozituar si më sipër, shumë e cila ka qenë gjendje cash në banesë. Vlera prej 33,000 USD*

²³ Pyetësori nr.2, pyetja nr. 2, nënpyetja i/ përgjigjja e dërguar nga subjekti.

²⁴ Pyetësori nr.2, pyetja nr. 2, nënpyetja i / përgjigjja e dërguar nga subjekti.

dorëzuar shitësit si më sipër, konvertuar me kursin real të konvertimit 121.5 lek/USD është afërsisht e barabartë me 4,000,000 Lek [...].

Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar lëvizjet e llogarive dyemërore në emër të tij dhe bashkëshortes së tij në lekë dhe valutën euro në “Alpha Bank”.

Analiza e burimeve të deklaruarra për krijimin e kësaj pasurie

a. Kursimet - me burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes

Komisioni verifikoi dhe analizoi të gjithë të ardhurat e përfituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, të deklarara në deklaratën “Vetting”. Me qëllim analizimin e mundësisë financiare të kryerjes së pagesës në vitin 2003, për blerjen e pasurisë së llojit “apartament”, Komisioni evidentoi në veçanti të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij deri në datën 31.12.2003, ligjshmëria e të cilave konfirmohet me dokumentacion justifikues ligjor nga institucionet përkatëse, punëdhënësit të tyre.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, krahas të ardhurave të deklaruarra në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit pretendon disa të ardhura të tjera të përfituara nga bashkëshortja e tij ndër vite (kryesisht para vitit 2003), të ardhura përfituara nga punësimi, pjesëmarrja në projekte të ndryshme si edhe të ardhura të pretenduara si të kursyera nga bursat e studimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizë financiare vetëm të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga angazhimi/pjesëmarrja në projekte kërkimore - shkencore, e konkretisht për punën e kryer në projektet “****” dhe “****”, të ardhura këto të konfirmuara me vërtetimin nr. *** prot., datë 13.2.2020 të lëshuar nga Universiteti “****”, të cilat paraqiten në tabelën si më poshtë:

Emërtim projekti	Periudha	Shuma në LIT	Shuma në Eu	Kursi i këmb.	Shuma në Lek
***	22.6.1998	1358000		86,9	118,010
***	10.12.1999	1435600		70,94	101,841
***	10.2.2001	1435600		68	97,684
***	10.10.2001		522	128,69	67,176
***	1.4.2003		490	139,88	68,541
***	25.3.2001	2981856		67,84	202,289
	Total	7,211,056	1,012		655,541

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi të përfshihen në analizën financiare për pasuritë e krijuara prej tij dhe bashkëshortes deri në datë 31.12.2003, të ardhura shtesë nga puna e saj e pretenduar në shoqërinë “****”, pjesëmarrje në projekte tek “****” si edhe të ardhura nga bursat e studimit.

Pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet e dhëna dhe provat e depozituara nga subjekti, trupi gjykues vlerësoi të mos marrë në konsideratë këto të ardhura të pretenduara, pasi janë kryesisht të karakterit deklarativ dhe nuk përmubushin kushtet e parashikura në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për më tepër, vlerat monetare të përfituara nga bursa shërbejnë për shpenzime të shkollimit të bashkëshortes së subjektit dhe nuk mund të reflektohen si të ardhura dhe aq më tepër si burim krijimi pasurish.

b. Të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2000, në shumën prej 1,900,000 lekësh

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje²⁵ konstatohet se, në datën 28.7.2000 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë²⁶ pasurinë e llojit “apartament banimi” 2+1 me sipërfaqe totale 71.85 m², të ndodhur në Elbasan, për shumën 1,900,000 lekë.

Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën deri më 31.12.2000, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për blerjen prej tyre të pasurisë së llojit “apartament banimi” dhe mbulimin e shpenzimeve jetike, - analizë e pasqyruar në tabelën si më poshtë²⁷:

Analiza financiare deri në datën 31.12.2000	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin për periudhën	1,768,337
Të ardhura neto paga, shpërblime dhe honorare për bashkëshorten	718,104
Të ardhura të bashkëshortes nga proj. “****” dhe “****”	219,851
Kredi e marrë nga Fondi “Besa” në datë 19.12.2000	100,000
Total të ardhura/të hyra financiare (1)	2,806,292
Pagesë shpenzime minimale për konsum, për periudhën 1996-1999	430,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI viti 2000	180,000
Total shpenzime/pagesa (2)	610,000
Blerje pasurie apartament në vitin 2000	1,900,000
Total pasuri (3)	1,900,000
Balanca e fondeve (1-2-3)	296,292

↓ Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurisë së llojit “apartament banimi” në vitin 2000.

Rezulton se, në datën 9.5.2003 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij e kanë shitur²⁸ këtë pasuri, të llojit “apartament”, për vlerën 1,900,000 lekë.

c. Shuma prej 10,000 dollarë e deklaruar si e dhënë nga i vëllai për shkak të heqjes dorë nga bashkëpronësia e apartamentit në Elbasan dhe shuma prej 10,000 dollarë e deklaruar si e dhuruar nga prindërit e bashkëshortes

Sa më sipër, referuar pikës 14 të nenit 3 si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe prindërit e bashkëshortes bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të vëllait të tij dhe familjarëve të bashkëshortes, të cilat kanë shërbyer për krijimin shumave/vlerave monetare të dhëna/dhuruara prej tyre në favor të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

c.1. Lidhur me burimin e të ardhurave të vëllait të tij, subjekti i rivlerësimit në dosjen “Vetting” ka depozituar ndërmjet të tjerave dokumentacion provues si vijon: (i) vërtetim nga shoqëria “****” sh.a., për të ardhura të përfituara nga punësimi në periudhën dhjetor 1998 -

²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 9.10.2017 e ZQRPP-së, me anë të së cilës përcillet shkresa nr. *** prot., datë 20.9.2017 e ZVRPP-së Elbasan dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj (Aneks ***, në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁶ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2000.

²⁷ Analiza financiare është kryer deri në fund të vitit 2000 dhe jo në datën 28.7.2000 (datë e blerjes së apartamentit) për shkak se referuar dokumentacionit ligjor provues – vërtetimet e pagave, të ardhurat e tyre paraqiten vjetore.

²⁸ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2003

qershor 2000, në shumën neto 468,536 lekë; (ii) vërtetim nga shoqëria “****” sh.p.k., për të ardhura të përfituara nga punësimi në periudhën korrik 2001 - gusht 2003, në shumën neto 1,070,548 lekë dhe; (iii) të ardhura nga aktiviteti regjistruar me NIPT ***, shuma neto 285,000 lekë (300.000 lekë qarkullim -15.000 lekë tatime).

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan²⁹, konfirmon marrëdhëniet e punësimit të z. E. M., në këto shoqëri, por shuma e pasqyruar në vërtetimet për bazën e vlerësuar përfaqëson pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe jo pagën neto të marrë.

↓ **Nga analiza e të dhënave të mësipërme duket se, z. E.M., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka patur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 10,000 USD, të deklaruar si e dhënë në favor subjektit të rivlerësimit (për heqje dorë nga bashkëpronësia e apartamentit në lagjen “****”, Elbasan).**

Por, nga ana tjetër, Komisioni verifikoi vërtetësinë e deklaramëve të bëra nga subjekti në referim të të cilave, vëllai i tij E.M., i ka dhënë shumën prej 10,000 dollarë prej heqjes dorë nga bashkëpronësia në shtëpinë e prindërve.

Në deklarinimin fillestar të pasurisë, subjekti ka deklaruar se zotëron 25% të pasurisë së llojit “apartament banimi”, të ndodhur në lagjen “****”, pallati ***, rruga “****”, Elbasan, ndërtuar para vitit ‘90, përfutuar nga privatizimi, në bashkëpronësi me familjen.

Në DPV/2004, por edhe në deklarinimet e dhëna në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për prenotimin e apartamentit në Elbasan (prenotuar në vitin 2003) edhe shumën prej 10,000 dollarë të dhënë nga vëllai i tij, z. E. M., si pasojë e heqjes dorë nga pjesa takuese, që zotëronte në pasurinë e llojit “apartament”, në bashkëpronësi me prindërit.

Por, as në DPV/2004 dhe as në DPV-të vjetore të deklaruara në vazhdimësi nga subjekti në ILDKPKI duket se, nuk ka deklaruar saktësisht pakësimin e pasurisë/pjesës takuese prej 25% të apartamentit të përfutuar me ligjin e privatizimit, të deklaruar në deklarinimin fillestar të pasurisë.

Gjithashtu, konstatohet se, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kontratën e shitjes³⁰ datë 25.4.2012, referuar së cilës vëllai i subjektit, z. E.M., ka shitur pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 52.5 m², të ndodhur në lagjen “****”, pallati ***, shk. ***, k. ***, ap. nr. ***, Elbasan, për shumën 2,571,660 lekë.

Komisioni i kërkoi subjektit³¹ të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie prej tij dhe familjarëve të tij si edhe për të provuar heqjen dorë për pjesën takuese që zotëronte në këtë pasuri.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *ky apartament është përfutuar nga privatizimi dhe se, së bashku me prindërit dhe vëllain kanë rënë dakord, me mirëkuptim në familje, që kjo pasuri do të ndahej ndërmjet dy vëllezërve. Në vitin 2003, vit në të cilin filloi jetesën në familjen e re, “de facto” hoqi dorë nga pjesa e tij takuese, në këtë pasuri. Me qëllim blerjen e apartamentit të ri ku do banonte, vëllai i tij, E., i dha 10,000*

²⁹ Shkresa me nr. ***prot., datë 27.2.2020.

³⁰ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.4.2012.

³¹ Pyetësori nr. 3.

dollarë në këmbim të heqjes dorë nga pjesa e tij takuese, për të cilën ai përpiloi një deklaratë dore³².

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, *midis vëllezërve me mirëkuptim dhe faktikisht e kishin zgjidhur marrëdhënien financiare lidhur me këtë pasuri qysh në vitin 2003. Por, meqënëse vëllai donte ta shiste këtë pasuri dhe pasuria vazhdonte juridikisht të ishte në emër të gjithë pjesëtarëve të familjes shkuan te noteri për të bërë një prokurë me qëllim që ai në çdo kohë të kishte mundësi ta shiste... por se noteri i propozoi “kontratën e shitjes” si mënyrën më të thjeshtë, të shpejtë në kohë, me kosto më të ulët financiare që pasuria të kalonte në favor të vëllait. Për këtë arsye u përpilua kontrata e shitjes e vitit 2006, e cila në fakt kishte të vetmin qëllim, që juridikisht pasuria të kalonte në emër të vëllait, E., për veprime të mëtejshme për shitjen e saj.*

Subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion³³ dokumentacionin e plotë lidhur me këtë pasuri, që nga regjistrimi fillestar e deri në shitjen e saj nga vëllai i tij, z. E.M.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se, (i) kjo pasuri është përfituar nga subjekti i rivlerësimit, dy prindërit dhe vëllai i tij, bazuar në ligjin nr. 7562, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe është regjistruar në regjistrat hipotekore në bashkëpronësi me nga 25% secili, qysh në vitin 1993³⁴ dhe; (ii) në datën 24.10.2006 subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij, znj. E.M., dhe B.M., i kanë shitur³⁵ E.M., pjesën e tyre takuese mbi këtë pasuri në total për shumën 50,000 lekë. Këto të dhëna dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti për këtë pasuri konfirmohen edhe nga ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan³⁶.

↓ **Sa më sipër Komisioni konstaton se nuk përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacion e administruar lidhur me tjetërsimin e pjesës së tij takuese (25%) të kësaj pasurie.**

❖ **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke depozituar si provë të re deklaratën noteriale³⁷ të bërë nga vëllai i tij në datë 21.8.2020.

Referuar këtij dokumenti, z. E.M., ndër të tjera ka deklaruar se, *[...]Në vitin 1993 prindërit, unë dhe vëllai im, Alketi, privatizua në bazë të kontratë privatizimi banese (formularit nr.3) datë 25.9.1993 dhe kontratës së shitblerjes datë 27.9.1993, apartamentin e ndodhur në lagjen “***”, i cili u regjistrua në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në bashkëpronësinë tonë. Pavarësisht bashkëpronësisë, familjarisht ramë dakord se prindërit do të hiqnin dorë nga pronësia dhe banesën do ta gëzonim në pronësi të barabartë unë dhe vëllai im. Siç e thashë, ky ishte një vendim familjar dhe ne nuk kryem ndonjë veprim juridik për ta formalizuar atë, pasi secili prej nesh nga vëllezërit do të merrte pjesën që i takonte, mbas shitjes së këtij*

³² Dokument i depozituar nga subjekti edhe si pjesë e dokumentacionit shoqëruar në ILDKPKI, me dorëzimin e deklaratës “Vetting”.

³³ Përgjigjet e pyetësorit nr.3 - provat e depozituara bashkëlidhur, protokolluar në KPK nr. *** prot., datë 15.6.2020.

³⁴ Referohu dokumentave kontratë për privatizimin e banesës + kontrata për shitjen e banesës të vitit 1993 si edhe vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 29.9.1993.

³⁵ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2006.

³⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 17.6.2020.

³⁷ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2020.

*apartamenti tek të tretët jashtë familjes, meqënëse secili prej nesh, kishte plane për të banuar në apartamente me hapësirë më të përshtatshme. Kur Alketi po përgatitej të blinte një shtëpi për familjen e tij të re (pas martesë) në vitin 2003, brenda mundësive të mia i kam dhënë tim vëllai 10.000 USD, me qëllim që ai të blinte apartamentin ku do të banonte me familjen e tij, vlerë të cilën do ta mbaja nga të ardhurat, që do të krijoheshin nga shitja e mëvonshme e apartamentit tek të tretët jashtë familjes, që e kishim në bashkëpronësi. Për shkak të marrëdhënies vëllazërore dhe mirëbesimit reciprok, edhe në këtë moment nuk u krye ndonjë veprim juridik. Banesa kaloi në pronësinë time juridikisht tre vite më vonë, me aktin e shitjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 24.10.2006, në bazë të të cilit Alketi dhe dy prindërit e kaluan të gjithë pronësinë e këtij apartamenti në emrin tim, vetëm për qëllimin që unë të kisha tagra të plota, në shitjen e apartamentit në momentin më të parë që do të më krijohej mundësia, pasi prindërit në moshë të thyer dhe Alketi që ishte me punë në Durrës, më krijonin vështirësi në shitjen e tij, duke u dhënë unë atyre një shumë prej 50,000 lekë, pagesë simbolike. Më pas me kontratën e shitjes me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 25.4.2012, unë e shita këtë apartament në vlerën 2,571,660 lekë (afërsisht 20,000 USD pas pagimit të taksave dhe shpenzimeve të shitjes). Pra, vlera neto që unë kam përfituar nga shitja e këtij apartamenti (vlera e shitjes 20,000 USD minus 10,000 USD që i kisha dhënë Alketit në vitin 2003), është pothuajse e barabartë me vlerën që përfitoi Alketi [...]*

Gjithashtu në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, *pavarësisht nga mënyra e deklaramit, kjo shumë i është dhënë nga vëllai në vitin 2003.*

❖ Analiza e kryer nga Komisioni/Vlerësimi i provave

Pas analizës së të gjithë provave dhe fakteve të parashtruara si më sipër, Komisioni çmon se përparësi merr deklarami i bërë në vazhdimësi për dhënien e shumës prej 10,000 dollarë nga vëllai i subjektit, ligjshmëria e burimit të krijimit të saj, dhe jo arsyeja e dhënies së kësaj shume.

Në këtë kontekst, verifikimi i këtij fakti merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij.

Në kushtet kur fakti i deklaramit të marrjes së kësaj shumë është i pamohueshëm, konfirmuar edhe nga vëllai i subjektit, si edhe duke qenë se Komisioni e trajtoi si person tjetër të lidhur z. E.M., në mënyrë indirekte u pranua të trajtohej kjo shumë si dhurim dhe në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 u verifikua ligjshmëria e burimit të krijimit të saj.

Në rastet e dhurimeve, bazuar në germenin “f” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti ka patur detyrimin ligjor të deklarojë shumën e dhuruar dhe identitetin e personit prej nga ka ardhur dhurimi, detyrim ky i përmbushur nga subjekti.

Parë në këndvështrimin tjetër, nëse se kjo shumë do trajtohej si e përfituar nga heqja dorë/shitja e pjesës takuese të pasurisë (në rastin konkret e pamaterializuar me dokument ligjor), Komisioni nuk do i rezervonte vetes të drejtën për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të vëllait të subjektit, në kushtet kur, në këtë rast, do të kishim të bënim me marrëdhënie kontraktuale për shitjen e 25% të pjesës takuese të pasurisë së tij.

Komisioni vëren se mbas deklarimit të bërë në DPV/2004, për përfitimin e kësaj shume nga vëllai i tij si rezultat i heqjes dorë nga pjesa takuese e pasurisë në bashkëpronësi, subjekti nuk ka deklaruar dhe as ka pretenduar të ardhura të tjera nga shitja përfundimtare e kësaj pasurie.

Nga analizimi i deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlersimit dhe vëllai i tij në harmoni me provat e administruara lidhur me transaksionet e kryera për tjetërsimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se duken bindëse dhe reflektojnë situatën faktike – shpjegimet e subjektit lidhur me deklarimin e bërë në DPV/2004 për përfitimin e shumës 10,000 dollarë prej vëllait të tij si rezultat i heqjes dorë nga pasuria në bashkëpronësi.

c.2. Lidhur me burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortes

Rezulton se, me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur/depozituar dokumentacion për të provuar mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes së tij për dhurimin e shumës prej 10,000 dollarë.

Komisioni, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte dhe të provonte burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortes, të cilat kanë shërbyer për të dhurimin e shumës prej 10,000 dollarë në favor të bashkëshortes së tij.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se, *burimi i të ardhurave të tyre janë kursimet nga puna ndër vite dhe se, në referim të dokumentave bashkëlidhur sipas tij rezulton që, (a) të ardhura nga pensioni / paga e babait të bashkëshortes E.Z., për periudhën 1993-2003 janë 775,000 lekë; (b) të ardhurat nga qiraja e dyqanit të nënës së bashkëshortes H.Z., për periudhën 4.7.2001 - 3.7.2002 janë në vlerën 396,000 lekë; (c) të ardhurat nga paga e vëllait të bashkëshortes B.Z., deri më 31.12.2003 (beqar në atë kohë) janë 457,000 lekë; (d) nëna e bashkëshortes ka ushtruar aktivitet privat “Tregëti Ushqimore dhe Bulmet” me NIPT (kod Fiskal) *** për periudhën nga viti 1992 deri 30.6.2001. Pas kësaj periudhe dyqani është dhënë me qira sipas pikës b) të sipërpërmendur me një vlerë prej 33,000 lekë në muaj. Për këtë periudhë nga zyra e tatimeve nuk disponohen dokumente zyrtare mbi fitimet e realizuara. Për analogji për përllogaritjen e fitimit minimal për këtë periudhë ka marrë çmimin e qirasë, duke supozuar se fitimet e realizuara nga biznesi ishin pothuajse të njëjta me ofertën e qiramarrësit (vlerën vjetore me të cilën biznesi u dha qira). Konkretisht $33,000 \text{ lekeë/muaj} \times 96 \text{ muaj} (1993 - 2001) = 3,168,000 \text{ lekë}$ për këtë periudhë dhe; (e) të ardhura të përfituara nga shitja e mallrave 1 muaj para dhënies së dyqanit me qira, shuma prej 1,200,000 lekë [...].*

Referuar të dhënave të mësipërme subjekti pretendon se, totali i të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes së tij, për periudhën 1993 – 2003, janë në vlerën 5,996,000 lekë.

Për të provuar të ardhurat e përfituara për këtë periudhë nga familjarët e bashkëshortes, subjekti i ka bashkëlidhur deklarimit të tij dokumentacionin si vijon: (i) vërtetim nga ISSH Elbasan me nr. *** prot., datë 16.10.2018 për z. E.Z.; (ii) kontratë qiraje e dyqanit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.7.2001; (iii) vërtetim page për B.Z., nr. *** prot., datë 13.2.2020, lëshuar nga Alpha Bank; (iv) kthim përgjigjeje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan me nr. *** prot., datë 16.10.2018; (v) procesverbal i datës 1.7.2000 mbi inventarin e materialeve të dyqanit dhe; (vi) mandat pagese për detyrimet tatimore (për tatim fitimi dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetore) nga H.Z., gjithsej 30 copë.

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit duket se të dokumentuara janë: (a) të ardhurat e babait të bashkëshortes për periudhën 1993 – 31.12.2003,

në shumën 794,511 lekë; (b) të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e dyqanit referuar kontratës së qirasë për periudhën 3.7.2001 – 3.7.2002, në vlerë 33,000 lekë në muaj, vlera 396,000 lekë në vit, (megjithëse nuk dokumentohet pagesa e tatimit mbi qiranë) dhe; (iii) të ardhurat nga paga e vëllait të bashkëshortes, z. B.Z., për periudhën 9.12.2002 – 31.12.2003, në vlerën prej 457,424 lekë.

Për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti privat regjistruar në datë 21.1.1993 me objekt “*tregti ushqimore dhe bulmet*”, nuk ka të dhëna për të ardhura/qarkullim të deklaruara/të realizuara për këtë periudhë nga aktiviteti ose shitja e mallrave/pajisjeve.

Referuar shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan të datës 16.10.2018 (depozituar nga subjekti) konstatohet se, subjekti H.Z., është regjistruar e pajisur me certifikatë regjistrimi në organin tatimor, si person fizik, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Elbasan, me nr. ***, datë 21.1.1993, me kodin fiskal *** me aktivitet “*tregti ushqimore, bulmet*”, me adresë ***, Elbasan, më 9.1.1994 si vijon: për vitin 1994 tatimi i planifikuar dhe paguar vjetor në shumën 15,000 lekë. Gjithashtu, DRT Elbasan informon se në vitin 1994 subjekti është pajisur me kasë fiskale sipas kodit fiskal *** me nr. Mat. ***, *** dhe me datë instalimi 5.12.1994, ndërsa për të ardhurat dhe tatimin për vitet 1995, 1996, 1997 e në vazhdim nuk disponojnë dokumentacion.

Duke marrë në konsideratë faktin se një pjesë e të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes mbeten të natyrës deklarative, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dokumentuar plotësisht ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 10,000 dollarë.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Me dërgimin e prapësimeve, subjekti kërkoi që Komisioni të pranojë si të ardhura të ligjshme shtesë në analizën financiare të personave të tjerë të lidhur edhe (i) të ardhura nga aktiviteti tregtar i nënës së bashkëshortes; (ii) të ardhura shtesë nga qiradhënia e dyqanit dhe; (iii) të ardhura të tjera të bashkëshortes së tij, duke depozituar prova të reja në mbështetje të deklarimeve/pretendimeve të tij. Me përfshirjen e këtyre të ardhurave, subjekti kërkon të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare të familjarëve të bashkëshortes së tij, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e shumës 10,000 dollarë.

❖ Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i nënës së bashkëshortes, bazuar në raportin e ekspertit/audituesit ligjor³⁸, znj. A.Gj.³⁹, subjekti i rivlerësimit pretendon se fitimi neto i realizuar për vitet 1992 – 2001 është në vlerën prej 2,605,759 lekë.

Trupi gjykues administroi në cilësinë e provës këtë raport të audituesit ligjor, duke e vlerësuar në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë procesit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti.

Komisioni vëren se, raporti i audituesit ligjor lidhur me fitimin e mundshëm neto të realizuar nga aktiviteti tregtar është bazuar në dokumentacion e dorëzuar nga subjekti (dokumentacion i depozituar edhe në Komision), kryesisht në mandatmagesat e tatimit për vitet 1992 – 1996, vlerësuar këto dokumenta të cilat pasqyrojnë indicie të besueshme në raport me legjislacionin

³⁸ Raport i bërë me kërkesën e tij.

³⁹ Paisur me licensën e audituesit ligjor lëshuar nga IEKA, me nr. ***, datë 15.10.2008.

fiskal të kohës. Ndërsa, për vitet që nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni, për shkak të kohës shumë të largët dhe pas kalimit të çdo afati për ruajtjen e dokumentacionit, eksperti ka kryer përlllogaritjet e tij, duke u bazuar në metodën alternative.

Bazuar në parashikimet e legjislacionit tatimor të kësaj periudhe (**ligjin nr. 7545 datë 6.1.1992** “Për tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë në sektorët privatë të tregtisë, artizanatit e të shërbimeve të tjera”⁴⁰ ; **ligji 7590, datë 16.7.1992**⁴¹, për disa ndryshime në ligjin 7545 datë 6.1.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë në sektorët privatë të tregtisë, artizanatit e të shërbimeve të tjera”; **ligji nr. 7679, datë 3.3.1993** “Për tatimin mbi biznesin e vogël”⁴²), si dhe shumë të tatimit të paguar realisht nga personi fizik (bazuar në aq dokumenta sa janë vënë në dispozicion – kopje të mandateve), duke qenë se tatimi në këtë periudhë paguhej bazuar në një përqindje të caktuar (6%, 10% apo 5%) mbi qarkullimin e realizuar (xhiron), eksperti pretendon se ka arritur të përlllogarisë qarkullimin e realizuar faktik nga ky tatimpagues.

Ndërsa, në përlllogaritjen e fitimit neto për vitet 1992 - 1997, ai ka përcaktuar një normë mesatare fitimi prej 40%, pasi, sipas tij, në këtë kohë normat e fitimeve kanë qenë të larta për shkak të kërkesës së lartë konsumatore në krahasim me ofertën për mallra konsumi si dhe të konkurrencës të vogël në treg. Ndërsa për vitet 1998 – 2001, për shkak të rritjes së ofertës së mallrave të konsumit si dhe shtimin e bizneseve të reja në treg, pra, rritja e konkurrencës, normat e fitimit kanë patur një tendencë ulje graduale, dhe për këtë arsye, janë përlllogaritur nga eksperti në masën 30%-35%.

Gjithashtu, në vijim të përpjekjeve për dokumentimin e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet tregtar, subjekti i rivlerësimit/personi tjetër i lidhur (znj. H.Z.,) i janë drejtuar sërish Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, nëpërmjet së cilës i kërkojnë informacion për aktivitetin e subjektit tregtar regjistruar me kod fiskal ***, duke i vënë në dispozicion edhe mandatetpagesat e tatimeve për vitet 1992 – 1996.

DRT-ja Elbasan⁴³, ndër të tjera, informon se për subjektin H.Z., regjistruar e pajisur me certifikatë regjistrimi në organin tatimor si person fizik, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. ***, datë 21.1.1993, për të ardhurat dhe tatimin për vitet 1993, 1994, 1995, 1996, 1997 e në vazhdim, për shkak të situatës së vitit 1997, nuk disponojnë dokumentacion.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se raporti i audituesit ligjor si edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duke u konsideruar si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të germës “b” të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, marrin vlerë provuese të rëndësishme,

⁴⁰ Neni 3 “Për personat fizikë që ushtrojnë veprimtari në njësi të veçanta, zbatohen tarifa të tatimit proporcional në këtë masë:b) Tregtarët që shesin mallra konsumi industrial, ushqimor dhe produkte të tjera të gatshme, **10 për qind**.Neni 6”Tatimi me tarifa proporcionale derdhet në **katër** këste në afatet 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 30 nëntor të çdo viti.Tatimi mbi tarifa fiskale derdhet në mënyrë të barabartë për çdo muaj jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

⁴¹ Në nenin 3 bëhen këto ndryshime: Shkronja "a" dhe "b" bashkohen dhe ndryshohen si vijon: a) Tregtarët që shesin prodhime të përpunuara vetë, mallra konsumi industrial e ushqimor si dhe produkte të tjera të gatshme, **6 për qind të arkëtimeve nga shitja e këtyre mallrave.**

⁴² Neni 3 “Llojet e veprimtarive që taten **me tarifa proporcionale mbi të ardhurat** dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie, janë: a) **Tregtarët me pakicë** që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre **në dyqane** ose në njësi të tjera të veçanta, **5 për qind, por jo më pak se 12 mijë Lekë në vit**. Neni 6 Tatimi mbi të ardhurat derdhet në **4 këste** në afatet 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 30 nëntor të çdo viti. Tatimi me kuota fikse derdhet në mënyrë të barabartë për çdo muaj jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

⁴³ Shkresa nr. *** prot., datë 17.8.2020.

për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me provat, të dhënat e informacionet rreth aktivitetit tregtar të kryer nga nëna e bashkëshortes së subjektit.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi tjetër i lidhur ka bërë gjithë përpjekjet e mundshme, me qëllim sigurimin e dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar dhe se gjendet në kushtet e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”*.

Në këtë kuptim, në kushtet kur Komisioni krijoi bindjen se nëna e bashkëshortes së subjektit ka kryer aktivitet tregtar, Komisioni vendosi të pranojë pretendimet e subjektit për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave dhe metodologjinë analoge të përdorur nga audituesi ligjor për vlerësimin e tyre.

Ndërsa të ardhurat shtesë të pretenduara nga qiradhënia e dyqanit, si edhe nga pjesëmarrja e bashkëshortes së subjektit në projekte të ndryshme (para martese), mbeten kryesisht të karakterit deklarativ – të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor.

Parë në një këndvështrim tjetër, në dritën e rrethanave të evidentuara si më sipër, fakteve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se edhe sikur këto të ardhura të pretenduara nga aktiviteti tregtar i nënës së bashkëshortes apo të ardhurat e tjera të pretenduara për këtë periudhë të mos të reflektohen në rubrikën e të ardhurave, mjafton që të vlerësohen se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të familjes së saj - dhe në këtë rast të ardhurat e provuara me dokumentacion justifikues ligjor, të evidentuara si më sipër, mundësojnë plotësisht krijimin e shumës prej 10,000 dollarë të deklaruar nga subjekti/personi i lidhur në DPV/2004, si të dhuruar nga familjarët e bashkëshortes.

↓ Si përfundim, referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të gjithë rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, trupi gjykues krijoi bindjen se familjarët e bashkëshortes së subjektit kanë patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës prej 10,000 dollarë të pretenduar si të marrë nga subjekti dhe personi i lidhur në vitin 2003, deklaruar për herë të parë në vitin 2004.

🚦 Vlerësimi i momentit të marrjes në dorëzim të dy vlerave mometare të dhëna/dhuruara nga familjarët, prej 10,000 USD secila

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” konstatohet se janë paraqitur dy deklarata të thjeshta, sipas të cilave: (i) në vitin 2004 vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. E.M., i ka dhënë shumën prej 10,000 dollarë kundrejt heqjes dorë nga pronësia mbi apartamentin 1+1, lagjja “***”, rruga “****”, pallati ***, Elbasan dhe po ashtu; (ii) prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, H., dhe E.Z., në vitin 2004 i kanë dhuruar vajzës së tyre, M.M., shumën prej 10,000 dollarë si ndihmë për blerjen e shtëpisë së saj, shtëpi e blerë nga ajo dhe bashkëshorti i saj.

Vërehet se këto dy deklaratat janë depozituar nga subjekti edhe si pjesë e dokumentacionit shoqëruar të pyetësorit nr. 2, megjithëse subjekti në përgjigje të këtij pyetësi pretendon se këto shuma – vlera monetare i janë dhënë në vitin 2003.

▼ Sa më sipër, Komisioni konstaton se ka *mospërputhje mes deklaramit të subjektit dhe deklaratave të nënshkruara nga prindërit e bashkëshortes dhe vëllai i tij* për kohën e dhënies së shumave prej 10,000 dollarë.

Bazuar në përmbajtjen e këtyre deklaratave, të depozituara nga vetë subjekti, shuma prej 20,000 dollarë (10,000 dollarë deklaruar si dhënë nga i vëllai dhe 10,000 dollarë e deklaruar si dhurim nga familjarët e bashkëshortes, nuk u morën në konsideratë si burim krijimi i pasurisë së llojit “apartament” të porositur dhe paguar plotësisht nga subjekti gjatë vitit 2003.

❖ **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Nëpërmjet prapësimeve të dërguara subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, *është gabim material shënimi i vitit 2004 si moment i dhënies së këtyre shumave në deklaratat e nënshkruara nga vëllai i tij dhe prindërit e bashkëshortes. Paga e plotë për blerjen e kësaj pasurie, në shumën prej 4,000,000 lekë është e provuar se është paguar në vitin 2003 dhe se prej tij, kur është deklaruar për herë të parë kjo pasuri në vitin 2004, është deklaruar se burimi për kryerjen e kësaj pagese janë dhe dy shumat e dhuruara nga familjarët, referuar si më sipër – del qartë fakti se në dy deklaratat e thjeshta të lëshuara nga vëllai dhe nëna e bashkëshortes (të cilat janë depozituar nga ana ime) reflektojnë një gabim material, ku pasqyrojnë se shumat janë dhënë në vitin 2004, në vend që të pasqyronin se këto deklaratat janë nënshkruar në vitin 2004.*

Për të provuar pretendimet e tij, ka depozituar 2 deklaratat notoriale⁴⁴ të datës 21.8.2020, njëra e nënshkruar nga vëllai i tij, z. E.M., dhe tjetra e nënshkruar nga nëna e bashkëshortes së tij, znj. H.Z.

❖ **Vlerësimi i kryer nga Komisioni/Analiza e provave**

Siç u evidentua më sipër, në deklaramin fillestar të pasurisë⁴⁵ krahas mosdeklarimit të pasurisë së llojit “apartament banimi” nuk janë deklaruar edhe vlerat monetare të pretenduara si të dhënë/dhuruara nga vëllai i subjektit dhe familjarët e bashkëshortes, të marra në dorëzim në vitin 2003.

Ndërsa në DPV/2004, me deklaramin e pasurisë së llojit “apartament banimi”, të ndodhur në Elbasan dhe referuar dokumentacionit ligjor, prenotuar dhe paguar shuma e plotë prej 4,000,000 lekë që në vitin 2003, subjekti ka pretenduar se si burim krijimi të saj kanë shërbyer edhe shuma e dhënë nga vëllai i tij prej 10,000 dollarë dhe shuma e dhuruar nga familjarët e bashkëshortes prej 10,000 dollarë.

Vlen të theksohet fakti se si arsye të dhënies së shumës prej 10,000 dollarë nga vëllai i tij subjekti ka deklaruar se është heqja dorë prej tij nga pasuria në bashkëpronësi me vëllain dhe prindërit e tij.

⁴⁴ Deklarata notoriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2020 dhe deklarata notoriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2020.

⁴⁵ Deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në datë 24.3.2004.

Por, nga ana tjetër, vërehet se në deklarinimin fillesar (deklarim i cili përfshinte pasuritë gjendje deri në datë 31.12.2003) subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament” në bashkëpronësi me familjarët dhe pjesën takuese të tij prej 25%.

Në këtë kontekst, nisur nga vetëdeklarimet e bëra nga subjekti duket se në vitin 2003 ai nuk kishte hequr dorë as *de jure* as *de facto* nga pasuria në bashkëpronësi me familjarët e tij. Si rrjedhojë logjike, vëllai i tij nuk i ka dhënë këtë shumë gjatë vitit 2003, por mund ta ketë dhënë gjatë vitit 2004, ashtu sikurse përcaktohet edhe në deklaratën e nënshkruar prej tij, të depozituar nga subjekti si pjesë e dokumentacionit shoqërues të deklaratës “Vetting”.

Për më tepër, nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarinimit të pasurive”⁴⁶ mbajtur në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjes nr. 1, *subjekti ndër të tjera ka deklaruar se, ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit (i referohet apartamentit në bashkëpronësi me familjarët) në vitin 2004, meqë krijoi familjen e tij dhe shuma prej 10,000 dollarë i është dhënë nga prindërit dhe vëllai, pa dokument noterial, por me një deklaratë dore të vëllait.*

Si dokumentacion mbështetës të deklarinimit të tij, ka depozituar deklaratën e nënshkruar nga vëllai i tij, z. E.M., sipas të cilës në vitin 2004 ai i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumë prej 10,000 dollarë kundrejt heqjes dorë nga pronësia mbi apartamentin 1+1, lagjja “****”, rruga “****”, pallati ***, Elbasan, e njëjta deklaratë e depozituar edhe me dorëzimin e dokumentacionit shoqërues të deklaratës “Vetting”.

Gjithashtu, vërehet se pjesë e dokumentacionit shoqërues të këtij procesverbali subjekti ka depozituar deklaratë e thjeshtë të nënshkruar nga prindërit e bashkëshortes, sipas të cilës në vitin 2004 i kanë dhuruar vajzës së tyre, M.M., shumë prej 10,000 dollarë si ndihmë për blerjen e shtëpisë së saj, shtëpi e blerë nga ajo dhe bashkëshorti i saj.

▼ **Në analizë të provave dhe të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me pasaktësinë e këtyre dy deklaratave dhe si rrjedhojë, këto dy vlera monetare (në total vlera prej 10,000 dollarë) nuk do merren në konsideratë si burim krijimi i pasurisë së llojit “apartament” të porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, duke mos u reflektuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për të gjitha pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deri në 31.12.2003.**

Referuar deklaratës fillestare të pasurisë të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, veçmas në ILDKPKI konstatohet se, krahas pasurisë së llojit “apartament banimi” të evidentuar si të prenotuar në vitin 2003 dhe paguar shuma prej 4,000,000 lekë brenda këtij viti, kanë deklaruar se disponojnë edhe pasuritë si vijon: (i) gjendje likuiditetesh *cash* subjekti, vlera prej 2,500,000 lekësh; (ii) gjendje likuiditetesh *cash* bashkëshortja 400,000 lekë; (iii) gjendje likuiditetesh në bankë bashkëshortja - shuma prej 600,000 lekësh dhe; (iv) autoveturë në emër të subjektit me vlerë 200,000 lekë.

➤ Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ,

⁴⁶ Përcjellë nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2020.

Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.3.1996 – 31.12.2003, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

❖ Analiza financiare me rezervë periudha 1.3.1996 - 31.12.2003	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin për periudhën	3,395,611
Të ardhura neto paga dhe shpërblime të bashkëshortes për periudhën	2,089,405
Të ardhura të bashkëshortes nga proj. “****” dhe “****” ref. shk.nr. *** prot., datë 13,02,2020 të Universitetit Elbasan	655,541
Të ardhura nga shitja e apartamentit 2+1 në Elbasan në datë 9.5.2003	1,900,000
Të ardhura të tjera interesa (B.Thesari, “Alpha bank”)	153,162
Total të ardhura/t hyra financiare	8,193,719
Shpenzime për interesa kredie nga Fondi “Besa” marrë në periudhën 2000-2002 shlyer 2001-2003	21,900
Pagesë shpenzime minimale për konsum, për periudhën 1996-1999	430,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI (2000-2003)	962,500
Total shpenzime	1,414,400
Ndryshim mj.monetare deklaruar <i>cash</i> gj. fillim-gj. fund periudhe	-2,900,000
Ndryshim mj.monetare banke dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	- 604,233
Mjete monetare të disponueshme (1)	3,275,086
Blerje Autoveture “Mercedes –Benz” EL ***	200,000
Blerje apartament 1+1 ne Elbasan me kontratë në datë 28.7.2000 (shitur në vitin 2003)	1,900,000
Blerje apartament 120 m ² referuar aktmarrëveshjes datë 5.12.2003 dhe deklaratës datë 22.12.2003	4,000,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	6,100,000
Balanca e fondeve (1-2)	- 2,824,914

↓ Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për pasurinë e llojit “apartament banimi” të prenotuar në vitin 2003 në Elbasan, për blerjen e pasurisë së llojit autoveturë, krijimin e depozitës bankare, likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni dhe të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera deri në datë 31.12.2003.

➤ Në vijim, lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se⁴⁷, *apartamenti është marrë në dorëzim i papërfunduar (karabina) në dhjetor 2003 dhe në vitin 2004 ai ka investuar 2,500,000 lekë nga shuma cash e kursyer ndër vite (e deklaruar gjëndje në DPV-në e vitit 2003) për punimet e nevojshme edhe të domosdoshme, duke përfshirë rifiniturat, instalimet elektrike dhe hidraulike, shtrimin me pllaka, vendosjet e dyerve të brendshme dhe dritaret.*

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) deklaratë noteriale⁴⁸ të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k, datë 8.2.2020 si dhe; (ii) preventivin për objektin apartament 2x (1+1), objekt hetimi, të përpiluar nga inxhinieri S.Sh.

Referuar deklaratës noteriale të datës 8.2.2020, z. E.K., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., deklaroi se i ka dhënë për vlerën 4,000,000 lekë me aktmarrëveshje, z. Alket Mersini, një sipërfaqe ndërtimi prej 120 m² të llojit “apartament” dhe se kjo pronë e marrë në dorëzim nga z. Alket Mersini në vitin 2003 ka qenë në fazë karabina, ku ka pasur vetëm derën e blinduar dhe të gjitha punimet e brendshme u morën përsipër për t’u kryer me

⁴⁷ Pyetësori nr.2, pyetja nr. 2, nënpyetja ii dhe v/ përgjigjet e dërguara nga subjekti.

⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.2020, redaktuar nga noteri A.M.

shpenzimet e veta. Ndërsa referuar preventivit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, shpenzimet e kryera nga subjekti për punime të kryera në këtë apartament kanë qenë 2,359,852 lekë.

Konstatohet se me aktmarrëveshjen⁴⁹ e datës 5.12.2003, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur pasurinë e sipërpërmendur dhe se pagesa për kryerjen e të gjitha punimeve në dy apartamentet me strukturë 1+1, të cilat do të adoptohen me shpenzimet e firmës, me sipërfaqe 120 m², është 4,000,000 lekë. Por, vërehet se në rekuizitën “*Afati dhe cilësia e kryesjes së punimeve*” të kësaj aktmarrëveshjeje, në paragrafin e parafundit të faqes 2, theksohet shprehimisht se; “*shtrimi me pllaka i ambienteve të brendshme si dhe të banjove edhe pajisjeve hidrosanitare do të përballohen nga vetë blerësi*”.

Gjithashtu, konstatohet se në DPV/2004 subjekti ka deklaruar pakësimin e shumës prej 2,500,000 lekë (deklaruar në deklaratën fillestare si gjendje *cash*), për blerjen e shtëpisë.

Pra, duket se krahas shumës prej 4,000,000 lekë të paguar nga subjekti gjatë vitit 2003 për blerjen e kësaj pasurie, në një lloj forme/mënyre subjekti ka deklaruar dhe shumën prej 2,500,000 lekë si shpenzim të kryer për blerjen e kësaj pasurie.

I pyetur nga Komisioni për shpenzimet e arredimit të këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁵⁰, *mobilitimi i këtij apartamenti është kryer gjatë vitit 2004 – 2005 dhe vlera e përfaqësuar e tyre është rreth 5,000 euro çdo vit, në total vlera e mobilimit është afërsisht 10,000 euro*.

Sa më sipër duket se, në total vlera e investuar për këtë pasuri nga subjekti ka qenë rreth 7,700,000 lekë e përbërë nga: (i) shuma prej 4,000,000 lekë paguar në vitin 2003 për porositjen e tij, (ii) shuma prej 2,500,000 lekë sipas vetëdeklarimit për punime të kryera gjatë vitit 2004 në këtë pasuri dhe; (iii) shuma prej 10,000 euro (konvertuar rreth 1, 200,000 lekë) për shpenzime mobilimi të kryera gjatë viteve 2004 – 2005.

🚧 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit prej 120 m², në Elbasan Komisioni i kërkoi subjektin të rivlerësimit të shpjegojë nëse janë paguar detyrimet tatimore nga të ardhurat e përfituara prej tij dhe personi të lidhur nga kalimi/transferimi nëpërmjet aktmarrëveshjes së datës 25.3.2011 i të drejtave reale që zotëronin mbi apartamentin në qytetin e Elbasanit.

Sikurse u evidentua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se mbas pagesës së kryer në vitin 2003 për blerjen e kësaj pasurie, gjatë viteve 2004 dhe 2005 ka kryer investime, që kanë të bëjnë me punime të brendshme dhe shpenzime arredimi.

Lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga kalimi/transferimi i të drejtave mbi këtë pasuri, nëpërmjet deklarimeve të tij të depozituara në Komision përmes përgjigjeve të pyetësorit nr. 2⁵¹, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera pretendon se: (i) në vitin 2011 nuk kishte hyrë akoma në fuqi detyrimi i plotësimit e dorëzimit të deklaratës integrale dhe mënyra e pagesës së tatimit mbi të ardhurat e fituara si rezultat i shitjes së një të drejte të

⁴⁹ Konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 5.12.2003, redaktuar nga notere I.P.

⁵⁰ Pyetësi nr.2, pyetja nr. 2, nënpyetja vii/ përgjigjja e dërguar nga subjekti.

⁵¹ Pyetësi nr.2, pyetja nr. 11, nënpyetja v/ përgjigjja e dërguar nga subjekti.

fituar; (ii) nuk ka pasur detyrim ligjor në ligjin e kohës për të paguar tatim për të ardhurat e realizura nga shitja e një të drejte të përfituar me kontratë, pasi nuk është përcaktuar kjo e ardhur në grupin e të ardhurave të tjera, si dhe kjo e drejtë nuk është e drejtë e autorit ose intelektuale; (iii) në aktmarrëveshje është përcaktuar ndër të tjera se porositësi (blerësi i të drejtave) ka detyrimet që në momentin e regjistrimit/hipotekimit, të paguajë të gjitha detyrimet sipas tarifave dhe ligjit, ku përfshihen dhe detyrimet tatimore, që në vlerësimin e tij duhej të pagueshin në zyrat e ZVRPP-së dhe; (iv) edhe në qoftë se për këtë të ardhur do të paguhej tatim, nga ana procedurale nuk ishte e mundur marrja e një formulari për kryerjen e pagesës, pasi ky formular nuk ka ekzistuar në drejtoritë tatimore dhe se, bankat pranojnë pagesa për detyrimet tatimore vetëm nëpërmjet formularëve të dhëna nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilat përcaktohen si të dhënat për tatimpaguesin dhe detyrimi tatimor për t'u paguar.

Pas analizës së shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komision vlerëson se, momenti në të cilin legjislatori ka parashikuar plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave për individët me të ardhura vjetore mbi 2,000,000 lekë nuk ndikon dhe as nuk është përcaktues në deklarin dhe pagesën e detyrimeve tatimore të parashikuara në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat nuk parashikon shprehimisht detyrimin për të paguar tatimin nga të ardhurat shtesë të përfituara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi një pasuri të paluajtshme. Por, referuar shkonjës “g” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: *të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.*

Subjekti pretendon se, sipas pikës 2.3.9 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”⁵² në grupin e të ardhurave të tjera parashikohej se (të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në nenin e sipërcituar, pika 1, germa “g”) përfshihen të ardhurat nga *sponsorizimet* dhe të ardhurat e realizuara nga *aktiviteti profesional* si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj..., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore.

Në të tilla rrethana, subjekti sqaron se pavarësisht se ai kishte marrë në posedim madje dhe kishte investuar në këtë pasuri, ai nuk ishte bërë pronar i kësaj pasurie të paluajtshme, sepse gjatë kohës që ai e posedoi atë, ajo nuk ishte regjistruar në ZVRPP. Pra, ai zotëronte vetëm të drejta kontraktuale që rridhnin nga aktmarrëveshja e datës 5.12.2003. Në këto kushte, subjekti pretendon se nuk ka pasur detyrim ligjor në ligjin e kohës për të ardhurat e realizuara nga kalimi/transferimi i të drejtave të përfituara me kontratë, pasi kjo e ardhur nuk është përcaktuar në grupin e të ardhurave të tjera, si edhe kjo e drejtë, nuk është e drejtë e autorit ose intelektuale.

Por, nga ana tjetër duket se të ardhurat e realizuara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga tatimi, referuar nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

⁵² Sipas parashikimeve të këtij udhëzimi në vitin 2011.

Sa më sipër, duket se subjekti ka pasur detyrim për deklarimin dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat shtesë (diferenca midis çmimit të dokumentuar të shitjes së të drejtave mbi këtë pasuri në vitin 2011 me çmimin e dokumentuar të paguar për prenotimin/porositjen e kësaj pasurie në vitin 2003) të përfituara nga transferimi i të drejtave reale mbi pasurinë të sipërcituar.

Në këtë këndvështrim, në analizën paraprake financiare shuma prej 8,500,000 lekësh (si e ardhur shtesë nga kalimi i të drejtave reale për këtë pasuri të përgjithshme në regjistrat publikë, për të cilat nuk është paguar detyrimi tatimor) nuk është marrë në konsideratë.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Pas iu kalua barra e provës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka patur detyrim për pagesë tatimi lidhur me të ardhurat e përfituara nga transferimi i të drejtave reale sipas aktmarrëveshjes së datës 25.3.2011.

Në parashtrimet e tij subjekti ka pretenduar se, *në ligjin e kohës nuk parashikohej detyrimi për të paguar tatim për të ardhurat e realizura nga shitja e një të drejte reale mbi një pasuri të paluajtshme të përgjithshme (jo në pronësi), pasi legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat, në kohën e realizimit të kësaj të ardhure, nuk parashikonte si të ardhur të tatueshme të ardhurat shtesë të përfituara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi një pasuri të paluajtshme të përgjithshme. Tatueshmëria e kësaj të ardhure (të ardhurat e realizura nga shitja e një të drejte reale të përfitur me kontratë) është parashikuar për herë të parë vetëm me ndryshimet që iu bënë ligjit 8438 me **ligjin nr. 94/2018, datë 03.12.2018 “Për një ndryshim në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”**”.*

Në vijim të parashtrimeve të tij subjekti ka arsyetuar se, në momentin kur ka përfitur të ardhurat sipas marrëveshjes së datës 25.3.2011, pika dh) e nenit 4 të ligjit 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, nëntitulli “burimi i të ardhurave” parashikonte se: *“Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:...dh) të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Ndërsa, pas ndryshimeve që u bënë me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018, pika dh) e nenit 4 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” ndryshoi si më poshtë: *“Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:*

*... dh) të ardhurat nga: (i) pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin **nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë;** (ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave dhe; (iii) **Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet “i” dhe “ii”, më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme**”.*

Nga krahasimi i parashikimeve ligjore të pikës dh) të nenit 4 të ligjit nr. 8438 (në vitin 2011 dhe pas ndryshimeve të vitit 2018) rezulton se burim i të ardhurave të tatueshme në vitin 2011 ishin të ardhurat nga **pronësia** mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe të ardhurat nga të **drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia** mbi sendet e paluajtshme. Ndërsa, në vitin 2018 në kategorinë

e të ardhurave të tatueshme u përfshinë edhe të **ardhura që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme**, pa u kufizuar vetëm në të ardhurat që rrjedhin nga të **drejtat e pronësisë**. Pra, në vitin 2011 tatoheshin vetëm të ardhurat që rridhnin nga pronësia.

Për sa më sipër, qëndrimi i mbajtur nga subjekti përmbledhet në faktin e pretenduar se ligji në vitin 2011 e kufizon burimin e të ardhurave të tatuara vetëm nga të ardhurat e fituara nga **të drejtat e pronësisë**, ndërsa në vitin 2018 burimi i të ardhurave **zgjerohet edhe me të drejta të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme**.

Përveç analizës së sipërcituar në prapësimet e tij, subjekti ka radhitur edhe disa rrethana me anë të të cilave kërkon të provojë veprimet e tij transparente për këto të ardhura të përfituara, të pasqyruara si më poshtë vijon:

1. Aktmarrëveshja është hartuar para noterit publik;
2. Kjo aktmarrëveshje dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e të drejtave janë deklaruar para organit publik ILDKPKI –së;
3. Në DPV/2011, ka deklaruar saktësisht këtë aktmarrëveshje, vlerën e përfituar nga shitja, llogarinë bankare të bashkëshortes ku është derdhur shuma, të gjitha të dhënat e nevojshme. Pra, në asnjë rast nuk është munduar ta fshehë këtë transaksion;
4. Në nenin 32 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” në titullin “*Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale*” parashikohet se: “*Kur pasuritë e fituara gjykohen se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm ose inspektorati i ulët njofton organet tatimore*”. Edhe Memorandumi nr. *** prot., datë 30.3.2009 mes ILDKPKI-së dhe DPT-së, është nënshkruar pikërisht për këtë qëllim. Pra, ILDKPKI megjithëse ka pasur informacion të plotë për këtë transaksion, nuk ka gjykuar se shuma e përfituar (pasuria në formë likuiditetesh prej 12,500,000 lekësh) të jetë pasuri e fituar si rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale dhe në dijeninë e tij nuk e ka referuar si rast në organin tatimor. Për më tepër, ka pasur dhe kontroll nga ILDKPKI dhe në asnjë rast nuk i është evidentuar ky fakt.
5. Vetë Komisioni i ka kërkuar interpretim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëse në rastin konkret ekziston detyrim për pagesë tatimi dhe siç u theksua edhe më sipër, DPT-ja në shkresën e dërguar Komisionit nuk referon asnjë të dhënë si për detyrimin, ashtu dhe për pagesën.

Për sa analizoi më sipër dhe në vlerësim të rrethanave të tjera të paraqitura për këtë transaksion, subjekti kërkonte të përfshihet në analizën financiare shuma prej 8,500,000 lekësh (si e ardhur shtesë nga kalimi i të drejtave reale për këtë pasuri të paregjistruar në regjistrat publikë), si ardhur plotësisht e ligjshme e përfituar prej tij dhe personit të lidhur.

❖ **Analiza ligjore/vlerësimi përfundimtar i kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat shtesë të përfituara nga aktmarrëveshja e vitit 2011 për kalimin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme**

Referuar nenit 6 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se, *detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjisllacionit tatimor*.

Ndërsa në nenin 4 me titull “*Burimi i të Ardhurave*” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to, siç janë të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

Pika 1, e nenit 7, i ligjit të sipërcituar përcakton se, *individëd rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave.*

Siç është evidentuar edhe më sipër, referuar shkonjës “g” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: *të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.*

Për më tepër, është evidentuar edhe fakti se të ardhurat e realizuara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga tatimi, referuar nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në këtë kuptim, pavarësisht se subjekti pretendon se kjo e ardhur e realizuar nuk është parashikuar në mënyrë eksplicite si e ardhur e tatueshme, Komisioni vlerëson se z. Mersini apo personi i lidhur me të si subjekt të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” (referuar më sipër) kanë patur detyrimin e deklarimit të të ardhurës shtesë të realizuar/përfituar nga transaksioni i kryer në vitin 2011 dhe pagesën e tatimit përkatës.

↓ **Si përfundim, trupi gjykues çmon se të ardhurat shtesë (diferenca midis çmimit e dokumentuar të shitjes së të drejtave mbi këtë pasuri në vitin 2011 me çmimin e dokumentuar të paguar për prenotimin/porositjen e kësaj pasurie në vitin 2003) të përfituara prej subjektit dhe personit të lidhur nga transferimi i të drejtave reale mbi pasurinë e sipërcituar, nuk përmbushin kushtet e parashikura në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës, *pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Si të tilla, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare si burim i ligjshëm i krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.***

❖ Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Analiza financiare periudha 1.1.2011 - 31.12.2011	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin	969,502
Të ardhura neto paga dhe shpërblime për bashkëshorten	1,156,846
Të ardhura nga shitja e ap. me sip.120 m ² në Elbasan (pa llogaritur të ardhurat shtesë)	4,000,000
Të ardhura të tjera interesa kreditore	367,030
Total të ardhura/të hyra financiare	6,493,378
Shpenzime për interesa kredie	1,083,610
Pagesë e shumës së mbetur nga çmimi i Ap. tek “***” (58.406 eu-15.000 eu)	6,106,790

Shpenzime interesa <i>overdrafti</i> dhe komisione	21,121
Shpenzime udhëtimi, pushime	366,775
Shpenzime për qira deklaruar	60,000
Shpenzime për mobilim deklaruar pyet.2	700,000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI	546,480
Total shpenzime	8,884,776
Ndryshim mj.monetare deklaruar <i>cash</i> gj. fillim-gj. fund periudhe	-700,000
Ndryshim mj.monetare banke, dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-4,444,781
Mjete monetare të disponueshme	-7,536,179

↓ Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për pasurinë e llojit “apartament banimi”, të prenotuar në vitin 2011 te ***, Tiranë, për krijimin e depozitës në bono thesari, likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni dhe të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011.

25. Pasuria e llojit “autoveturë”⁵³, e markës “Mercedes-Benz”, tip “C220, CDI”, vit prodhimi 2003, me targë AA ***, blerë në datën 13.1.2015, me vlerë 3,000 euro, subjekti zotëron 50% pjesë të kësaj pasurie. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat ndër vite nga pagat.

▪ Deklarimi i kësaj pasurie në vite: referuar DPV/2015 subjekti ka deklaruar blerjen e autoveturës së markës “Mercedes-Benz” 220, tip “E-Class”, vit prodhimi 2003, në vlerën 3,000 euro + 1,000 euro paguar për detyrime doganore dhe taksa, me burim krijimi kursimet e tij.

🚦 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

DPSHTRR-ja⁵⁴, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar mjete me targë AA ***, duke na dërguar dosjen e plotë të këtij mjeti.

Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja konstatohet se: (i) referuar certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 23.4.2008 nga autoritetet italiane, ky mjet është blerë në shtetin italian nga shtetasi E.M., (nuk disponohen të dhëna për çmimin e blerjes së këtij mjeti në Itali); (ii) në datën 30.4.2008 shtetasi E.M., nëpërmjet prokurës së posaçme⁵⁵ autorizon subjektin e rivlerësimit të kryente procedurat e zhdoganimit dhe regjistrimit të këtij mjeti, ta përdorte atë brenda dhe jashtë vendit, si edhe të kryente të gjithë procedurat për shitjen, duke vendosur vetë për çmimin dhe mënyrën e likuidimit/ose të kryente të gjithë procedurat për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të tij; (iii) në datën 12.1.2015 subjekti i rivlerësimit ka kryer zhdoganimin e këtij mjeti, duke paguar në total detyrimet doganore dhe tatimore për zhdoganimin e tij në vlerën prej 53,641 lekësh (vlera statistikore mbi bazën e së cilës janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjeti – referenca e aplikuar nga dogana është 268,210 lekë) dhe; (iv) në datën 13.1.2015 është nënshkruar kontrata⁵⁶ e shitblerjes së këtij mjeti me targë CK***.

Referuar kontratës së shitblerjes së këtij mjeti konstatohet se, çmimi i përcaktuar është në vlerën prej 3,000 euro dhe se kjo vlerë është dhënë në favor të palës shitëse jashtë zyrës

⁵³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (1) kontratë shitblerje nr. ***, datë 13.1.2015 dhe; (ii) prokurën e posaçme nr. ***, datë 30.4.2008.

⁵⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 20.9.2019.

⁵⁵ Prokura e Posaçme me nr. ***rep., nr. ***kol., datë 30.4.2008.

⁵⁶ Kontratë shitblerje (automjeti) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2015.

noteriale, para hartimit të kësaj kontrate. Por, vërehet se në cilësinë e shitësit ka nënshkruar subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues me prokurë i shtetasit E.M.

I pyetur nga Komisioni nëse e ka pasur në përdorim këtë automjet dhe për marrëdhënien që ai ka pasur me shtetasin E.M., subjekti i rivlerësimit deklaroi se⁵⁷, [...] këtë automjet e ka përdorur vetëm 2-3 muaj në vitin 2007 më pas nuk e ka përdorur më dhe se z. E.M., ka qenë mik i një shokut të tij [...].

Konstatohet se subjekti ka deklaruar se e ka përdorur këtë mjet vetëm për 2-3 muaj në vitin 2007, ndërkohë që referuar dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, prokura e lëshuar nga shtetasi E.M. për përdorimin e këtij mjete nga subjekti i rivlerësimit mban datën 30.4.2008. Nuk disponohen të dhëna për datën e hyrjes së këtij mjete në territorin shqiptar.

Ndërkohë, nga të dhënat e sistemit “TIMS” rezulton se në datën 28.11.2011 subjekti i rivlerësimit me këtë mjet ka kryer dalje/hyrje nga pika kufitare e Qafë Thanës.

Për sa sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për mospërputhjet në deklaratimet e tij, si edhe të sqarojë në mënyrë shteruese marrëdhënien e plotë me shtetasin E.M., dhe faktin se pse ai i ka lënë prokurë të posaçme me tagra të plota mbi këtë pasuri.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, *me shtetasin E.M., është njohur në qytetin e Durrësit, përpara vitit 2008, nëpërmjet shokut dhe kolegut të tij të punës, shtetasit K.B. Në muajin prill të vitit 2008, ai dhe K., janë takuar me E., për të pirë kafe. Në bisedë e sipër, meqënëse ai nuk kishte makinë në përdorim në atë kohë, E., i sugjeroi një makinë të tij, të tipit “Benz” me targë CK***, për ta përdorur, me të cilën kishte ardhur atë muaj nga Italia, derisa ai vetë të blinte një makinë. Për këtë fakt ai përpiloi një prokurë në të cilën përveç të drejtës për ta përdorur, i ka dhënë edhe të drejtën që këtë automjet ta shiste tek çdo person, pasi ai do largohej përsëri për në Itali. Këtë automjet e ka përdorur disa muaj në vitin 2008 (viti 2007 në deklaratimet e mëparshme është lapsus nga ana e tij) deri kur unë ka blerë automjetin “Opel Corsa” (18 Shtator 2008 deklaruar dhe në DPV-në e vitit 2008). Më pas, automjetin e mësipërm, meqënëse E., ndodhej në Itali, e ka dorëzuar së bashku me K., pranë familjarëve të tij që banojnë në Durrës. Në nëntor të vitit 2011, është takuar përsëri në Durrës, ku E., sapo kishte ardhur nga Italia dhe gjatë bisedës me të, ai i sugjeroi të blinte automjetin e sipërcituar. Pasi ranë dakord, e ka marrë automjetin për ta provuar nga ana teknike, duke bërë një rrugë deri në Ohër të Maqedonisë. Në momentin e kalimit në PKK Qafë Thanë, automjeti ka dhënë probleme teknike, të cilat e kanë detyruar të kthehet. Kjo vërtetohet dhe nga sistemi TIMS, ku hyrja dhe dalja është në një interval kohë afërsisht prej 5 minutash. Në këto kushte ia ka kthyer automjetin përsëri në fillim të muajit dhjetor 2011 kur dhe ai ka ardhur ne Shqipëri. Në vitin 2015, gjatë një bisede në rrjetet sociale, ka rënë fjala për automjetin e mësipërm dhe i ka thënë përsëri nëse ishte akoma i interesuar ta blinte në vlerën prej 3,000 Euro pa doganë. Pasi automjeti qe në gjendje të mirë teknike dhe ai ishte i pajisur me prokurë, ka kryer procedurat e zhdoganimit të automjetit, duke paguar dhe taksat për ditët e qëndrimit në Shqipëri, dhe më pas duke kryer targimin e mjetit në emrim e tij. Shumën prej 3,000 euro ia ka dhënë familjarëve të tij.*

⁵⁷ Pyetësori nr.2, pyetja nr. 15, nënpyetjet i dhe ii/ përgjigjet e dërguara nga subjekti.

❖ Vlerësimi i bërë nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

Pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në harmoni me provat e administruara në dosje, Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit janë bindëse lidhur me pasaktësinë e bërë në deklarinin gjatë pyetësoreve se e ka përdorur këtë mjet gjatë vitit 2007, por nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna për marrëdhënien e tij me shtetasin E.M., dhe faktin se pse ai i ka lënë prokurë të posaçme me tagra të plota mbi këtë pasuri.

Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri, duke analizuar në harmoni provat e administruara në dosje gjatë hetimit administrativ, duket se ky automjet që nga momenti i hyrjes në Republikën e Shqipërisë është përdorur dhe poseduar nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, duket se në vazhdimësi subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar i këtij automjeti, çka bën që Komisioni të ngrejë dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri që në prill të vitit 2008 është porositur dhe blerë nga subjekti i rivlerësimit, por për rreth 7 vjet është munduar të fshehtë ekzistencën dhe deklarinin e burimit të pagesës së kryer për blerjen e tij.

26. Gjendje Cash, në shumën prej 700,000 lekësh

Referuar deklaratave periodike vjetore të dorëzuara ndër vite në ILDKPKI, duket se ndër vite subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash*, të cilat mundësojnë krijimin shumës prej 700,000 lekë,-deklaruar si gjendjes *cash* në deklaratën “Vetting”.

Bazuar në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI si dhe në deklarinimet e dhëna prej tij në përgjigje të pyetësorit 2 të dërguar nga Komisioni, duket se lëvizja e likuiditeteve gjendje *cash* në fund të çdo viti kalendarik paraqitet si më poshtë:

Viti	Gjendje 31/12	Shtesa/Pakësime deklaruar
2003	2900000	
2004	0	(-2900000)
2005	0	0
2006	500,000	(+500,000)
2007	1,100,000	(+600,000)
2008	1,700,000	(+600,000)
2009	700000	(-1700000+700,000)
2010	1,700,000	(+1,000,000)
2011	2,400,000	(+700,000)
2012	3600000	(+1,200,000)
2013	4,400,000	(+800,000)
2014	6,200,000	(+1800000)
2015	4,724,000	{(-10,000 eu-4,000eu+1500eu)-560,000+800,000}
2016	3,224,000	(-1,500,000)
Vetting, datë 26.1.2017	700,000	

Për sa sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegime për ecurinë e gjendjeve të likuiditeteve *cash* ndër vite dhe nëse ka pasur pakësime të tjera përveçse atyre të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, duke deklaruar destinacionin e shumës rreth 2,500,000 lekë (3,224,000 lekë – 700,000 lekë), shumë e cila, referuar deklarinimeve të bëra prej tij dhe personit të lidhur ndër vite, duket se disponohej *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, krahas shumës prej 700,000 lekësh.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, diferencat ndërmjet përlllogaritjeve të kryera Komisioni dhe përlllogaritjeve të kryera prej tij dhe gjendjes faktike të likuiditeteve *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” qëndrojnë si më poshtë:

- a) Nuk është përlllogaritur saktë në vitin 2013 se shuma prej 281,547 lekësh nga kursimet kanë kaluar në bankë. (kursimet në shumën 800,000 lekë përbëhen nga 281,547 lekë rritja e llogarive bankare + 518,453 lekë *cash*);
- b) Në vitin 2014 kursimi është 180,000 lekë dhe jo 1,800,000 lekë, pra, rezulton se gabimisht nga ana e tij është shtuar një zero;
- c) Në vitin 2015 *cash*-i është zvogëluar me 14,000 euro dhe jo me 12,500 euro, pasi 1,500 euro nga shitja e mjetit “Opel” janë shpenzuar për konsum gjatë vitit 2015;
- d) Në vitin 2016 shpenzimet e udhëtimit në Greqi janë përballuar nga kursimet.

❖ Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

Në kushtet kur nuk ka indicie të besueshme për investimin e shumës të pretenduar prej 2,500,000 lekë (në pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aktivitet tregtar të mundshëm) të përlllogaritur nga Komisioni si gjendje *cash* krahas gjendjes së deklaruar nga subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, trupi gjykues çmon se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me ecurinë e gjendjeve të likuiditeteve *cash*. Pasaktësitë në deklaratimet ndër vite vlerësohen se janë pa pasoja dhe si të tilla nuk u morën në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar.

➤ Pasuri e deklaruar veçmas nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit

27. Gjendje në bono thesari⁵⁸ në datën 20.1.2017, vlera prej 7,000,000 lekësh dhe se zotëron 100% të kësaj pasurie. Si burim krijimi personi i lidhur ka deklaruar: (i) diferencën ndërmjet çmimit të përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan me çmimin e blerjes së apartamentit tek “****” në Tiranë; (ii) kursimet nga pagat ndër vite dhe; (iii) interesat bankare të përfituara.

▪ Deklarimet në vite të depozitave në formë bono thesari

Referuar deklaratës fillestare të pasurisë (dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.4.2004), konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar depozitë bankare në bono thesari në vlerën 600,000 lekë, me burim krijimi kursimet familjare. Referuar DPV/2004 konstatohet se në rubrikën “*Informacion konfidencial*” subjekti ka deklaruar shumën prej 1,000,000 lekë në bono thesari, në emër të bashkëshortes së tij, znj. M.M. *Për periudhën 2005 – 2008, nuk janë deklaruar gjendjet e shumave të investuara në bono thesari.*

Referuar DPV/2011 konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar depozitimin e shumës prej 4,700,000 lekë me maturim 1-vjeçar (datat 13.10.2011 – 11.10.2012). Referuar DPV/2014 konstatohet se personi i lidhur deklaroi ndryshim në depozitën bankare në “Alpha Bank” – në bono thesari, në vlerën 4,200,000 lekë. Referuar DPV/2015 konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shtesë bonot e thesarit në Bankën e Shqipërisë me maturim 1-vjeçar, shumën prej 1,300,000 lekësh, nga të cilat 740,000 lekë kanë si burim mbylljen e depozitës në “BKT” të deklaruar më parë dhe 560,000 lekë nga kursimet e mbledhura (shtesa faktike e

⁵⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (1) vërtetim nga Banka e Shqipërisë, datë 20.1.2017; (2) deklaratë nr. ***, datë 20.1.2017 nga Alpha Bank.

pasurisë 560,000 lekë). Referuar DPV/2016 konstatohet se, personi i lidhur ka deklaruar shtesë në bono thesari, shumën prej 1,500,000 lekë, me burim kursimet ndër vite nga pagat të akumuluar në shtëpi.

▪ **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

Referuar të dhënave të dërguara nga Banka e Shqipërisë⁵⁹ dhe “Alpha Bank”⁶⁰ rezulton se, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka disponuar shuma të investuara në bono thesari në Bankën e Shqipërisë që prej vitit 2002, **gjendjet** e të cilave sipas viteve paraqiten në tabelën si më poshtë:

viti	gjendje 31/12 (në lek)
2002	650,000
2003	600,000
2004	1,000,000
2005	1,000,000
2006	811,075
2007	800,000
2008	800,000
2009	0
2010	0
2011	4,700,000
2012	0
2013	0
2014	4,200,000
2015	5,500,000
2016	7,000,000

Gjithashtu, sikurësë është evidentuar më sipër nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga “Alpha Bank”, rezulton se në datë 25.3.2011 është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit shuma prej 12,300,000 lekësh me përshkrimin “*kalim nga N. A., për blerje apartamenti*” dhe se, në datë 6.10.2011 është aplikuar për bono thesari në shumën 4,700,000 lekë.

Në vijim, në datën 1.11.2012 është rikthyer investimi nga bono thesari në vlerën 4,667, 300 lekë dhe në datën 2.11.2012 është futur në depozitë me afat shuma 4,670,000 lekë, kthyer para afatit në datën 6.5.2013 në vlerën 4,765,311 lekë. Në datë 6.8.2013 është mbyllur depozita me afat në vlerën 4,205,931 lekë dhe në të njëjtën datë shuma prej 4,000,000 lekë ridepozitohet me afat. Në datën 24.9.2014 është mbyllur përpara afatit llogaria depozitë në vlerë 4,194,400 lekë. Ndërsa në datën 3.10.2014 shuma prej 4,200,000 lekësh është transferuar për pjesëmarrje ankandi bono thesari.

Ndërsa referuar të dhënave nga “BKT”-ja, rezulton se në datë 30.9.2015 është depozituar *cash* shuma prej 1,300,000 lekësh dhe në datën 23.3.2016 është depozituar *cash* shuma 1,500,000 lekë.

▪ **Lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite**

Si burim të ardhurash për krijimin e shumës së investuar në bono thesari nga viti 2011 e në vazhdim është deklaruar: (i) diferenca e krijuar nga shitja e dy apartamenteve 1+1, të adoptuar

⁵⁹ Shkresa me nr. *** prot., datë 19.9.2019.

⁶⁰ Shkresat me nr. *** prot., datë 16.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.2.2020.

në një apartament me sipërfaqe prej 120 m², sipas aktmarrëveshjes së datës 25.3.2011, në vlerën 12,500,000 lekë dhe blerjes së apartamentit me sipërfaqe 110.2 m², në rezidencën “***”, sipas kontratës datë 21.10.2011, në shumën prej 58,406 euro si dhe; (ii) kursimet nga pagat ndër vite dhe interesat bankare të përfituara.

Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2011, duket se subjekti nuk ka patur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e pagesës për prenotimin apartamentit të “***”, krijimin e kursimeve *cash* dhe krijimin e depozitës në bono thesari.

↓ **Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se depozita gjendje në bono thesari deklaruar në deklaratën “Vetting” rrjedh nga depozita në bono thesari e hapur në vitin 2011 me burim shitjen e pasurisë në Elbasan, Komisioni konston se subjekti/personi i lidhur nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e saj – fakt ky i evidentuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për mundësi e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit të “***”, Tiranë.**

28. Çështje/gjetje të tjera

Referuar të dhënave nga “Union Bank”⁶¹ rezulton se në datë 31.10.2011 në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë bankës “ICB” (ish-Banka Ndërkombëtare Tregtare përthithur nga Union Bank) është transferuar nga shoqëria “***” sh.p.k., shuma 40,774 euro, me përshkrimin “*për sa paguar tepër kësht apartamenti*”.

Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime lidhur me këtë transfertë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se⁶² *shuma prej 40,774 euro e tërhequr nga llogaria e shoqërisë “***” sh.p.k., nga bashkëshortja, zj. M.M., në datë 31.10.2011, është një veprim i kërkuar gabimisht nga ana e shoqërisë “***” sh.p.k., e cila e konstatoi dhe e korrigjoi këtë gabim po brenda ditës. Konkretisht, shuma e mësipërme e tërhequr nga bashkëshortja u depozitua në arkën e shoqërisë, e cila, po atë ditë e ka depozituar të njëjtën shumë në llogarinë bankare të saj. Kjo provohet nga mandati i arkëtimit në arkën e shoqërisë nga M.M., nga deklarata e shoqërisë për këtë gabim si dhe llogaria bankare e shoqërisë, në të cilën është riderdhur shuma e tërhequr gabimisht po atë ditë.*

Për të provuar deklaramet e tij subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin si vijon: (i) deklaratë e shoqërisë “***” sh.p.k., nr. *** prot., datë 16.10.2018; (ii) *statement* bankar i llogarisë së shoqërisë “***” sh.p.k.; (iii) mandatarkëtimi datë 31.10.2011 dhe; (iv) mandatpagesë datë 31.10.2011.

Referuar deklaratës së datës 16.10.2018, z. A.Ç., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k, deklaroi se në datë 31.10.2011 në llogarinë e znj. M.M., është depozituar nga ana e shoqërisë shuma prej 40,744 euro, shumë e cila është tërhequr nga znj. Mersini, duke u depozituar në arkën e shoqërisë “***” sh.p.k., dhe më pas, në po të njëjtën ditë, shoqëria e ka ridepozituar në llogarinë e saj nëpërmjet punonjësit z. B.R.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti konstatohet se të gjitha veprimet lidhur me këtë vlerë monetare janë kryer në datë 31.10.2011, e konkretisht: (i) bashkëshortja e subjektit ka tërhequr *cash* shumën prej 40,744 euro nga llogaria e saj në “ICB” (nëpërmjet dokumentit mandatpagesë); (ii) ka depozituar në arkën e shoqërisë këtë shumë (dokumenti

⁶¹ Shkresa me nr. *** prot., datë 26.9.2019.

⁶² Pyetësori nr.2, pyetja nr. 12.1 / përgjigjja e dërguar nga subjekti.

mandat arkëtimi nr. serial ***) dhe; (iii) kjo shumë është ridepozituar në llogarinë e shoqërisë, derdhur *cash* nga B.R. (konfirmuar nga *statementi* bankar i shoqërisë).

↓ Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme lidhur me këtë transaksion dhe qëllimin e kryerjes së tij. Për sa më sipër, iu kërkua subjektit të japi shpjegime shtesë dhe të paraqesi prova të reja të mundshme, duke sqaruar çështjet si vijon:

(i) si e dispononte firma ndërtuese numrin e llogarisë së bashkëshortes së tij kur të gjitha pagesat për prenotimin e pasurisë të kjo shoqëri janë kryer *cash*;

(ii) kush e njoftoi bashkëshorten e tij për transferimin e kësaj shume në llogarinë e saj;

(iii) si u bë e mundur tërheqja e kësaj shume në bankë brenda ditës, duke konsideruar faktin se për tërheqjet e vlerave monetare në shuma të konsiderueshme, referuar rregulloreve të bankave, duhet bërë njoftimi disa ditë përpara dhe;

(iv) pse bashkëshortja e tij nuk e ktheu këtë shumë nëpërmjet transfertës bankare.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çështjet e ngritura nga Komisioni kanë të bëjnë me natyrën operacionale të kryerjes së këtij transaksioni, për të cilin deklaroi se ka ndodhur disa vite më parë dhe nuk i kujtohen detajet. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ai dhe familja e tij nuk ka përfituar ndonjë vlerë monetare nga kryerja e këtij transaksioni, përveç faktit të sistemimit të gabimit të kryer nga shoqëria “****” sh.p.k., i cili përbën dhe thelbin e këtij transaksioni dhe që është provuar edhe me prova të administruara gjatë hetimit paraprak si: (i) deklaratë e shoqërisë “****” sh.p.k., nr. *** prot., datë 16.10.2018; (ii) *statement* bankar i llogarisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) mandatarkëtimi datë 31.10.2011 dhe; (iv) mandatpagesë datë 31.10.2011. Për sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se nuk ka prova të reja të mundshme, përveç atyre të paraqitura gjatë hetimit administrativ.

❖ Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë transaksion

Në vlerësimin përfundimtar, në dritën e fakteve të reja nga ku duket se llogaria në “Union Bank” është hapur nga bashkëshortja në ditën e kryerjes së transfertës nga shoqëria “****” sh.p.k., trupi gjykues çmon se nuk duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe se ka hije dyshimi për qëllimin e kryerjes së këtij transaksion të lidhura me trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria për çmimin e blerjes së apartamentit të “****”.

29. Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve ndër vite; (ii) ngrihen dyshime të arsyeshme se pasuria e llojit automjet megjithëse ka kalur në pronësi të subjektit formalisht në vitin 2015, që në prill të vitit 2008 është porositur dhe blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe se, me veprimet dhe mosveprimet e tij është munduar të fshehë këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj; (iii) ngrihen dyshime të arsyeshme për qëllimin e kryerjes së transfertës në favor të bashkëshortes së subjekti nga

shoqëria “****” sh.p.k., në tetor të vitit 2011 në vlerën prej 40,774 euro, të lidhura me trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria për çmimin e blerjes së apartamentit të “****”.

Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe; (2) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

B. KONTROLLI I FIGURËS

30. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin⁶³ mbi kontrollin e figurës, ku ka konstatuar se, (i) formulari i deklaramit është i plotë, i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar në krimin e organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtashmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini.

Komisioni i kërkoi DSIK-së përditësimin e raportit për vlerësimin e figurës, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini⁶⁴.

Në vijim, meqenëse në informacionet e dërguara rishtazi nga institucionet verifikuese nuk referoheshin të dhëna për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, Komisioni i kërkoi DSIK-së, deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës.

DSIK-ja⁶⁵, dërgoi raportin mbi kontrollin e figurës, të deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së, datë 15.6.2020, referuar të cilit konfirmohet konstatimi për përshtashmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini.

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjensitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin

⁶³ Raporti me nr. *** prot., datë 02.11.2017.

⁶⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 26.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 7.5.2020.

⁶⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.6.2020.

e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

31. Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

32. Subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini (i) në periudhën mars 1996 – maj 2004 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; (ii) në periudhën maj 2004 – prill 2012 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; (iii) në periudhën prill 2012 – maj 2014 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; (iv) në periudhën qershor 2014 – korrik 2016 ka ushtruar funksionin e prokurorit/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe; (v) për periudhën korrik 2016 – aktualisht, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

33. Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Ky raport⁶⁶ është përgatitur nga Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

a. Aftësitë profesionale

i. **Njohuritë ligjore.** Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Alket Mersini, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

ii. **Arsyetimi ligjor.** Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Alket Mersini shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, duke respektuar rregullat drejtshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi

⁶⁶ Raporti nr. *** prot., datë 15.5.2020.

rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

b. Aftësitë organizative

i. **Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.** Në analizë të të dhënave të administruara në kuadër të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale konstatohet se, subjekti Alket Mersini ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total në çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit. Gjithashtu nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se, nga ana e prokurorit Alket Mersini tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

ii. **Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore.** Subjekti i rivlerësimit Alket Mersini kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore, është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

iii. **Aftësia për të administruar dosjet.** Prokurori Mersini ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

i. **Etika në punë.** Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

ii. **Integriteti.** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Alket Mersini dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

iii. **Paanësia.** Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rena në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Alket Mersini. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

i. **Aftësitë e komunikimit.** Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rena në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

ii. **Aftësia për të bashkëpunuar.** Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimi i punës së subjektit Alket Mersini për vitin 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm

rezulton se: për vitin 2016, subjekti Alket Mersini është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

iii. **Gatishmëria për t’u angazhuar.** Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Alket Mersini rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

▪ **Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime**

i. Nga verifikimi në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit Alket Mersini nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ii. Në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme u gjetën vlerësimi i Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Alket Mersini që i përkasin punës së tij për vitin 2016, vlerësuar “shumë mirë”.

34. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe në dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese dhe; (iii) kriterëve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

34.1 Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithëanshëm lidhur me faktet e denoncuar në ankesat e depozituara nga publiku, bazuar në të dhënat e pasqyruara në denoncime, Komisioni i kërkoi⁶⁷ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të dërgojë fashikujt e plotë të dosjeve të kallëzimeve apo procedimeve që lidhen me to.

i. Denoncimi⁶⁸ i shtetasit K.D.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, se nuk ka kryer veprime hetimore lidhur me kallëzimin e bërë për kryeregjistruesin e ZVRPP-së Tiranë, znj. L.B., duke vendosur

⁶⁷ Shkresat, (i) nr. *** prot., datë 14.4.2020; (ii) nr. *** prot., datë 11.5.2020 dhe; (iii) nr. *** prot., datë 15.6.2020.

⁶⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 12.2.2018.

mosfillimin e procedimit penal. Denoncuesi shpjegon se, pasi iu drejtua Gjykatës, kjo e fundit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal, duke caktuar dhe detyra konkrete, por se prokurori Mersini nuk ka thërritur grupin e ZVRPP-së t'i ballafaqonte me faktet dhe provat.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi bashkëlidhur këtij denoncimi konstatohet se, mbas kallëzimit të bërë nga pronarët e truallit të familjes ***, përfaqësuar nga K.D., dhe M.T., (D.), Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (prokurori Mersini) ka vendosur regjistrimin e kalëzimit penal nr. *** për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” në ngarkim të shtetases L.B., dhe se, mbas verifikimeve të kryera, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal (vendimi i datës 28.7.2017).

Konstatohet se kallëzuesit kanë depozituar kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 28.7.2017, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, të vitit 2017”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se ankimi i kallëzuesve është i bazuar në ligj dhe në prova dhe me vendimin nr. *** akti, datë 23.11.2017 ka vendosur pranimin e tij, si rrjedhojë, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 28.7.2017 “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, të vitit 2017”, duke urdhëruar organin e prokurorisë të bëjë regjistrimin e procedimit penal. Në vendimin e saj gjykata ka përcaktuar edhe detyra konkrete për t'u kryer nga organi akuzës.

Mbas administrimit të dosjes plotë të këtij procedimi penal⁶⁹ ka rezultuar se, bazuar në vendimin e gjykatës të referuar si më sipër, më 14.1.2018 prokurori Mersini ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e këtij procedimi penal, numërtuar ***, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në vijim, vërehet se denoncuesi ka depozituar dy ankesa ndaj prokurorit Mersini lidhur me trajtimin e kallëzimit të bërë prej tij, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ndër të tjera përmend faktin se këtë prokuror e ka denoncuar në organet e *Vettingut* dhe se, në kushtet ku sipas tij tashmë gjendet në konflikt interesi me këtë prokuror, kërkon zëvendësimin e tij.

Prokurori Mersini, nëpërmjet dokumentit “kërkesë për dhënie pëlqimi” informon drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë se, sipas tij pretendimet e shtetasit K.D., nuk qëndrojnë, për faktin se, pavarësisht se ai ka bërë ankesë në organet e *Vettingut*, shpjegon se nuk ka asnjë bazë ligjore për zëvendësimin e tij. Megjithatë, për një hetim sa më objektiv dhe të paanshëm të këtij procedimi penal shpreh pëlqimin e tij që të zëvendësohet në ushtrimin e detyrës së prokurorit në çështjen penale nr. ***, të vitit 2018.

Më 15.5.2018, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e heqjes dorë, duke zëvendësuar prokurorin Mersini në hetimin e kësaj çështjeje.

Paraprakisht, nga studimi i dosjes së këtij procedimi penal dukej se, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në momentin e zëvendësimit të prokurorit Mersini (periudhë prej reth 4 muaj), veprimet hetimore të kryera për këtë dosje kanë qenë të vakëta.

⁶⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2020 dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, i është kërkuar subjektit të japi shpjegime mbi këtë denoncim dhe konstatimin e bërë nga Komisioni, si edhe të provonte me dokumente justifikuese veprimet hetimore të kryera nga prej tij si prokuror lidhur me këtë dosje, mbas regjistrimit të procedimi penal deri në momentin e zëvendësimit të tij.

❖ **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prapësimeve të dërguara ka shpjeguar se më 14.1.2018, mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, që siç rezulton edhe më pas, i është deleguar oficerit të policisë gjyqësore, znj. E.D., për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore të përcaktuara edhe në vendimin e Gjykatës. Konkretisht, janë kryer veprimet e mësipërme hetimore në mënyrë kronologjike si më poshtë:

- Më 25.1.2018 i është kërkuar me shkresë Gjykatës Administrative Tiranë vënia në dispozicion kopje të dosjes gjyqësore me paditës B.K., etj., dhe më 1.2.2018 është kthyer përgjigje se dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë.

- Më datë 25.1.2018 i është kërkuar me shkresë ZVRPP-së Tiranë për vënie në dispozicion të urdhrorit administrativ në lidhje me pasurinë objekt hetimi, procedurën e ndjekur si dhe emrat e personave që kanë përpiluar këtë urdher. Praktika e kërkuar është vënë në dispozicion më 7.2.2018.

- Më datë 25.1.2018 është dërguar urdhërthirrje për paraqitjen dhe pyetjen e shtetases M.T., dhe më 1.2.2018 është kthyer përgjigje se kjo shtetase ka ndryshuar adresë.

- Më 31.1.2018 i është marrë deklaram si person që tregon rrethana të dobishme të hetimit shtetasit K.D., i cili ka dhënë shpjegime rreth kallëzimit dhe pretendimet që ai ka.

- Më 14.2.2018 i është kërkuar me shkresë ZVRPP-së Tiranë vënia në dispozicion e urdhrorit administrativ në lidhje me pasurinë objekt hetimi, emrat e personave që kanë përpiluar këtë urdher dhe më 26.02.2018 është kthyer përgjigje, duke u vënë në dispozicion praktika e kërkuar.

- Më 26.2.2018 i është marrë deklaram si person që tregon rrethana të dobishme për hetimin shtetasit Th.L.

- Më 26.2.2018 i është marrë deklaram si person që tregon rrethana të dobishme për hetimin shtetasit D.V.

- Më 26.2.2018 me procesverbal këqyrje - marrje janë administruar dokumentet nga shtetasi Th.L.

- Më 31.2.2018 me procesverbal këqyrje-marrje janë administruar dokumentet nga shtetasi K.D.

- Më 13.3.2018 i është marrë deklaram si person që tregon rrethana të dobishme për hetimin shtetases L.B.

- Më 16.3.2018 është mbajtur procesverbali i ballafaqimit midis shtetases L.B., dhe shtetasit K.D.

- Më datë 23. 3.2018 është mbajtur përsëri procesverbal për këqyrje dokumentash të sjella nga ana e shtetasit K.D., dhe më pas rezulton se është paraqitur kërkesa për dorëheqjen e prokurorit Alket Mersini.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues, kopje të akteve procedurale nëpërmjet të cilave dokumentohen veprimet hetimore të kryera gjatë kohës që ai ka pasur në ndjekje këtë procedim penal, të listuara si më sipër.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit arsyeton se të gjitha këto veprime janë kryer në dinamikë dhe nuk janë të vakëta nga ana e oficerës së policisë gjyqësore, e cila ishte ngarkuar me hetimin e këtij procedimi, duke zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga ana e Gjykatës. Më pas, vjen menjëherë kërkesa për dorëheqjen e prokurorit Mersini, pasi kallëzuesi K.D., ka bërë ankesë në “Vetting” dhe ai ishte në konflikt interesi dhe megjithëse kjo kërkesë nuk kishte asnjë bazë ligjore, ai është shprehur dhe ka dhënë pëlqimin për zëvendësimin e tij, me qëllim për një hetim sa më të gjithanshëm dhe objektiv.

Në vijim të parashtrimeve subjekti ka shpjeguar se, siç rezulton dhe nga ky procedim penal, prokurori i cili e ka zëvendësuar, mbi bazën e shumicës së veprimeve hetimore të kryera gjatë kohës në të cilën e ka pasur ai në hetim dhe të lëna për t’u kryer nga gjykata, ka kërkuar pushimin e këtij procedim penal, i cili është pranuar nga gjykata.

❖ Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

Pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues çmon se duken bindëse dhe të provuara me dokumentacion justifikues shpjegimet e subjektit lidhur me veprimet hetimore - procedurale e kryera prej tij në këtë procedim penal. Nga studimi në tërësi i dosjes së këtij procedim penal, nuk ka indicie për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

ii. Denoncimi⁷⁰ i shtetasit N.C.

Denoncohet, ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit z. Alket Mersini, se me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. *** prot., datë 26.6.2017, mori në mbrojtje veprimet kriminale, duke i hapur rrugë rifillimit të ndërtimit pa leje të znj. G.C., fakt ky i kallëzuar nga ankuesi.

Referuar përgjigjes së ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷¹ dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj konstatohet se, trajtimin e kallëzimit penal nr. *** me kallëzues N.C., e ka bërë prokurorja A.S., dhe se në datën 12.7.2017 ka nxjerrë vendimin për mosfillimin e këtij procedimi.

Ne denoncimin e tij, megjithëse në vazhdimësi referon vendim pushimi nr. ***, gjithashtu duket se ankuesi ka përmendur dhe vendim pushimi nr. ***, datë 26.6.2017.

Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë e të gjithanshëm, në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni kërkoi⁷² Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vënien në dispozicion të fashikullit të plotë që i përket dosjes së procedimit penal nr. ***.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷³, dërgoi dosjen e plotë të këtij procedimi, nga verifikimi i së cilës konstatohet se, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi N.C., në datën 14.6.2017, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka përcjellë materialin referues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në këtë material referues në datë **14.6.2017**, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka **regjistruar kallëzimin nr. *****, për veprën penale të “shpërdorimit të

⁷⁰ Ankesa nr. *** prot., datë 25.5.2018.

⁷¹ Shkresa nr. ***prot., datë 29.4.2020.

⁷² Shkresa nr. ***prot., datë 11.5.2020.

⁷³ Shkresa nr. ***prot., datë 12.5.2020.

detyrës', parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, material i cili, pasi u hodh në short manual, në datën 15.6.2017 i ka kaluar për trajtim prokurorit Mersini.

Mbas studimit të materialeve të kësaj dosjeje dhe kryerjes të ndonjë veprimi hetimor shtesë, **në datë 20.6.2017**, prokurori Mersini **ka vendosur mosfillimin e procedimit penal** që lidhet me materialin kallëzues nr. ***, datë 14.6.2017.

Konstatohet se, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 24.7.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ky vendim i është përcjellë për njohje z. N.C.

Nga verifikimi i këtij denoncimi nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë fakt apo rrethanë konkrete nga mund të provohen pretendimet e denoncuesit për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive. Konstatohet se, kryesisht ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe ka të bëjë me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional dhe të figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini.

iii. Denoncimi⁷⁴ i shtetasit G. I. L.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, se ka marrë marrë mitë për pushimin e çështjes penale të filluar pas kallëzimit të bërë nga ana e tij për konsumimin e veprës penale “goditje për shkak të detyrës”.

Gjithashtu, denoncuesi pretendon se, në rrugë informale ka mësuar për pushimin e këtij procedimi penal, por se ai nuk është njoftuar zyrtarisht për vendimin e pushimit të kësaj çështjeje, megjithëse pretendon se ka bërë disa kërkesa për t'u njohur me të dhe se, në kushtet kur nuk ka marë dijeni për këtë vendim, nuk mund të ndjekë rrugën ligjore për veprime të mëtejshme. Denoncuesi, nuk i ka bashkëlidhur asnjë dokument shoqërues ankesës së tij të depozituar në Komision.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁵ dërgoi fashikullin e plotë të këtij procedimi penal, nga shqyrtimi i të cilit konstatohet se, bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi G.L., në datën 31.5.2016 Komisaritati i Policisë nr. 4, Tiranë ka bërë referimin e materialit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nisur nga ky material referues, në datë **1.6.2016** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur regjistrimin e kallëzimit me nr. *** dhe, në datë **21.7.2016** mbas trajtimit të këtij materiali nga Prokurori Mersini është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. *** i vitit 2016 për kryerjen e veprës penale të “goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal.

Në vijim, mbas kryerjes së disa veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim, në datën 14.7.2017 prokurori Mersini ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***.

Referuar dokumentacionit pjesë e kësaj dosjeje hetimore konstatohet se, me këtë vendim është njoftuar edhe z. G.L., nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 31.7.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷⁴ Ankesat nr. *** prot., datë 22.1.2019.

⁷⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 12.5.2020.

Denoncuesi pretendon se nuk është njohur me këtë vendim dhe se ka bërë disa kërkesa për t'u njohur me të, por ndërkohë nuk ka depozituar asnjë dokument provues bashkëlidhur denoncimit të tij.

Gjithashtu, nga verifikimi i këtij denoncimi nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë fakt apo rrethanë konkrete nga mund të provohen pretendimet e denoncuesit për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive. Konstatohet se kryesisht ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe ka të bëjë me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional dhe të figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Alket Mersini.

iv. Denoncimet⁷⁶ e shtetas D.Xh.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, se nuk ka kryer hetim të plotë për rrethanat e kallëzuar nga znj. Xh., dhe se, me anë të kësaj ankese pretendon te vendosë në lëvizje prokurorin e çështjes në hetimin që po zhvillohet.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁷, informoi Komisionin se dosja e procedimit penal nr. *** me kallëzuese znj. D.Xh., ndaj shtetasve A.S., G.H., Dh.K., E.S., M.Gj., A.J., A.H., dhe K.Z., ishte ende nën hetim.

Për sa më sipër, në kushtet kur dosja ishte ende në hetim, Komisioni nuk mund të trajtonte këtë denoncim.

v. Denoncimet⁷⁸ e shtetasit B.B.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini për marrjen e një vendimi të padrejtë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 29.5.2017, për faktin e kallëzuar nga ankuesi.

Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁹ konstatohet se, bazuar në kallëzimin e bërë nga shtetasi B.B., në datën 23.5.2017 Komisariati i Policisë nr. 4, Tiranë ka bërë referimin e materialit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa specifikuar veprat penale, të cilat dyshohen se janë konsumuar. Bazuar në referimin e bërë, në datën **24.5.2017** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur **regjistrimin e materialit kallëzues me nr. *****, për veprën penale të “*shpërdorimit të detyrës*”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Pas kryerjes së disa verifikimive lidhur me këtë kallëzim (për të cilin vërehet se edhe më herët ka pasur vendim pushimi nga Prokuroria për të njëjtat fakte të kallëzuar), në datë **29.5.2017** Prokurori Mersini ka nxjerrë **vendimin për mosfillimin e procedimit penal**.

Me shkresën e datës 9.6.2017, vendimi i mosfillimit i është dërguar për njohje shtetasit B.B.

⁷⁶ Ankesat nr. *** prot., datë 3.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 10.1.2019.

⁷⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2020.

⁷⁸ Ankesat nr. *** prot., datë 16.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2018.

⁷⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2020.

Nga verifikimi i këtyre denoncimeve si edhe dosjes së ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk duket të jetë ushtruar ankim nga z. B.B., ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal të nxjerrë nga prokurori Mersini.

Sa më sipër, nga analizimi i këtij denoncimi konstatohet se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe ka të bëjë me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

vi. Denoncimi⁸⁰ i shtetasit A.B.,

Referuar këtij denoncimi duket se, z. A.B., ka bërë kallëzim penal për disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë edhe për prokurorin Alket Mersini.

Nisur nga informacioni i përfituar nga trajtimi i këtij denoncimi se dosja që përfshin materialin kallëzues të z. A. B., është transferuar për moskompetencë lëndore nga Prokuroria për Krime të Rënda, Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸¹ të na vejë në dispozicion dosjen e plotë që lidhet me faktet e kallëzuara nga denoncuesi.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸², informoi Komisionin se dosja e procedimit penal nr. *** e vitit 2018 e Prokurorisë për Krime të Rënda, ardhur për kompetencë në këtë prokurori në datën 30.10.2018 dhe regjistruar nr. ***, me kallëzues shtetasin A.B., ishte duke u hetuar.

Për sa më sipër, në kushtet kur dosja ishte ende në hetim, Komisioni nuk mund të trajtonte këtë denoncim.

vii. Denoncimi⁸³ i shtetasit F.M.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, pasi ankuesi pretendon se prokurori Mersini ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për faktet e kallëzuara prej tij, pa e thirrur dhe pa e pyetur asnjëherë atë.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se kemi të bëjmë me kallëzim të bërë ndaj zyrtarëve të ZVRPP-së Tiranë dhe se, sipas denoncuesit, megjithëse ka paraqitur të gjitha provat dhe faktet që vërtetojnë falsifikimin e dokumentave të kryera nga zyrtarët e ZVRPP-së Tiranë, të cilat kanë sjellë mbivendosjen në pronën e tij, prokurori i çështjes ka vlerësuar se nuk ka vepër penale.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur denoncimit duket se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues, të dërguar nga shtetasi F.M., ka **regjistruar kallëzimin** penal me nr. *** të vitit 2017 (regjistruar datë **22.2.2017**), për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Konstatohet se, mbas kryerjes së veprimeve verifikuese-hetimore lidhur me këtë kallëzim, në datën **11.4.2017** prokurori Mersini ka vendosur **mosfillimin** e procedimit penal.

Ky vendim, në datë 28.4.2017 i është dërguar për njohje shtetasit F.M., (shkresa nr. *** prot. e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë), ku nga shqyrtimi i informacionit të dërguar nga denoncuesi nuk duket të jetë ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

⁸⁰ Ankesë e përcjellë nga institucioni i Komisionerit Publik, protokolluar në Komision nr. *** prot., datë 12.2.2019.

⁸¹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.4.2020.

⁸² Shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2020.

⁸³ Ankesa nr. *** prot., datë 20.2.2019.

Sa më sipër, nga analizimi i këtij denoncimi, duket se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe ka të bëjë me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

Megjithatë, nga vëzhgimi i kësaj dosjeje në zgjidhjen e këtij kallëzimi penal, **prokurori Mersini ka patur zvarritje të pajustificuar në marrjen e vendimit të mosfillimit**, duke shkeluar afatin 1- muajor përcaktuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, ku është përcaktuar se afati i verifikimit, të kallëzimit penal ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë.

❖ **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

Lidhur me konstatimin e bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve ka sqaruar se, *pavarësisht se ky material kallëzues është regjistruar më datë 22.02.2017 në regjistër, prej tij është marrë më 2.3.2017 dhe menjëherë mbas marrjes së këtij materiali kallëzues, ai i është dhënë oficerit të policisë gjyqësore për të kryer verifikimet e nevojshme dhe konkretisht më 8.3.2017, i është kërkuar me shkresë ZVRPP-së Tiranë kopje e dokumentacionit në lidhje me faktet e parashtruara në kallëzim, i cili rezulton se është vënë në dispozicion më 20.3.2017 dhe mbas studimit të tij nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, më 11.4.2017 i është vënë në dispozicion ky material kallëzues së bashku me relacionin e tij, dhe prej tij, po këtë datë, është marrë vendimi i mosfillimit, ku një kopje i është dërguar dhe kallëzuesit për njoftim.*

❖ **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit**

Komisioni vëren se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar pretendimet për datën e marrjes në regjistër prej tij të dosjes së këtij procedimi. Gjithsesi, në kushtet kur subjekti pretendon se nga momenti i marrjes në dorëzim të dosjes së këtij procedimi, për shkak të pritjes së informacionit nga ZVRPP-ja dhe në vijim të studimit të dosjes, i janë dashur rreth 1 muaj e 10 ditë për nxjerrjen e vendimit të mosfillimit, si dhe duke vlerësuar faktin se ky vendim i është dërguar për njohje kallëzuesit, duke mos cenuar të drejtën e tij për ankimi, Komisioni vlerëson se kjo gjetje ka peshë specifike shumë të vogël dhe si e tillë nuk është marrë në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

vii. Denoncimi⁸⁴ i shtetasit Sh.J.

Denoncuesi ka depozituar vendimin e mosfillimit të datës 12.9.2019. Nga verifikimi i këtij vendimi konstatohet se, në datën 12.9.2019 prokurori Mersini ka vendosur mosfillimin e materialit kallëzues me nr. *** prot., datë 30.7.2019, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, “shkatërrim prone”, “ndërrhyrje pa të drejtë në jetën private dhe kryerjen e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 248, 150, 121 dhe 250 të Kodit Penal.

Referuar formularit të kësaj ankese duket se denoncuesi ka paraqitur edhe më parë denoncim pranë ONM-së (IMO) dhe se, nëpërmjet këtij formulari depoziton vetëm vendimin e mosfillimit të nxjerrë nga prokurori Mersini, pas kallëzimit të bërë prej tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁴ Protokolluar në ONM (IMO) nr. ***prot., datë 8.11.2019.

Sa më sipër, nuk evidentohen arsyet për të cilat ankohet denoncuesi, përveçse faktit të supozuar që lidhet me vendimmarrjen e subjektit, meqënëse prokurori Mersini ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e bërë nga denoncuesi.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁵ i dërgoi Komisionit fashikullin e plotë të këtij kallëzimi nga shqyrtimi i të cilit konstatohet se bazuar në faktet e kallëzuar nga shtetasi Sh.J., është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 30.7.2019.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk evidentohet fakti se kur është marrë në dorëzim ky material kallëzues nga prokurori Mersini. Konstatohet se mbas kryerjes së disa veprimeve hetimore (veprime të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore në datat 11 dhe 12 shtator 2019) prokurori Mersini në datë 12.9.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Sa më sipër duket se, **prokurori Mersini ka patur zvarritje të pajustificuar në marrjen e vendimit të mosfillimit**, jashtë afatit 15 – ditor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

❖ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Në lidhje me këtë konstatim subjekti ka sqaruar se *ky material kallëzues është regjistruar më 30.7.2019, pra, ka qënë dita e parafundit e punës dhe më pas ai ka marrë lejen e zakonshme. Të gjitha materialet që regjistrohen në fund të muajit korrik, merren në fillim të muajit shtator, kur dalin në punë. Menjëherë sapo ka dalë në punë më 1.9.2019 këtë material kallëzues ia ka dhënë për verifikim oficerit të policisë gjyqësore, i cili, pasi ka kryer verifikimin më 11.9.2019 ia ka vënë në dispozicion materialin dhe ai menjëherë ka vendosur mosfillimin e këtij materiali kallëzues (nga data 1.9.2019 deri më 12.9.2019 nuk kanë kaluar 15 ditë) ku dhe në këtë rast një kopje i është dërguar dhe kallëzuesit për njoftim.*

❖ Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

Komisioni vlerëson se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me arsyet e vonesës në marrjen e vendimit të mosfillimit të këtij procedimi penal.

Nga studimi i dosjes së këtij procedimit penal, rezulton se, z. Sh.J., ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e mosfillimit të Prokurosisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas shqyrtimit të kësaj ankese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se, **vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë** “Për mosfillimin e procedimit penal që i përket kallëzimit penal nr. ***, i vitit 2019” **nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm** dhe për rrjedhojë, e ka shfuqizuar atë, duke urdhëruar organin e prokurorisë për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme (vendimi nr. ***, datë 5.3.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Gjithashtu, konstatohet se prokurori Mersini ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë; ankimi i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

➤ Sa më sipër, duket se kjo çështje është ende në shqyrtim gjyqësor.

⁸⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 19.6.2020.

Edhe në këtë rast, vlerësohet i rëndësishëm fakti se subjekti ka njoftuar kallëzuesit për vendimin e mosfillimit, duke mos cenuar të drejtën e tyre për ankim.

Si përfundim, nga analizimi i dosjes së këtij denoncimi, Komisioni çmon se, nuk nuk ka indicie për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Alket Mersini.

vii. Denoncimi⁸⁶ i shtetasit S.S.

Ankuesi denoncon ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit, prokurorin Alket Mersini. Nga verifikimi i kësaj ankese duket se prokurori Mersini denoncohet për vendimin e mosfillimit të datës 12.9.2019, në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2019, regjistruar mbi faktet e kallëzuara nga denoncuesi.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁷ i dërgoi Komisionit fashikullin e plotë të këtij kallëzimi nga verifikimi i të cilit konstatohet se, shtetasi S.S., ka kallëzuar dy zyrtarë, punonjës së ASHK-së Tiranë dhe se kallëzimin e tij e ka depozituar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pas shqyrtimit të këtij kallëzimi, ka çmuar se në bazë të neneve 74 dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale, kompetenca lëndore dhe tokësore për vlerësimin e tij i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke i dërguar për kompetencë aktet e këtij kallëzimi.

Në datën 6.9.2019 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, mbi faktet e kallëzuara nga shtetasi S.S., të përcjella nga pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Mbas verifikimeve të kryera lidhur me këtë kallëzim, në datë 12.9.2019 prokurori Mersini ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Me këtë vendim është njoftuar kallëzuesi, z. S.S., nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 20.9.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar dokumentacionit pjesë e kësaj dosjeje hetimore konstatohet se, z. S.S., ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. ***, datë 27.9.2019 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së bërë nga, z. S.S., duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për mosfillimin e procedimit penal që i përket kallëzimit penal nr. ***, datë 6.9.2019”. Rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

Si përfundim, nga analizimi i këtij denoncimi konstatohet se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe ka të bëjë me aspekte të vendimarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

⁸⁶ Protokolluar në ONM (IMO) nr. *** prot., datë 20.1.2020.

⁸⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 19.6.2020.

35. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

50.2 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a)** subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b)** subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c)** subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Alket Mersini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2.** Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 16.9.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesuese

Xhensila Pine
Anëtare

Pamela QIRKO
Relatore

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini